



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 409 Akti

Nr. 460 Vendimi  
Tiranë, më 20.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, zhvilloi në datën 18.10.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Manjola Bejleri**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prezente në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura prej saj në vijim të rezultateve të hetimit, dëgjoi relatoren e çështjes, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Manjola Bejleri është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si gjyqtare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga ku

rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Valbona Sanxhaktari.

2. Me vendimin e trupit gjykues të datës 8.1.2020, është vendosur kryesuese komisionere Xhensila Pine dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

4. Nga relatori i çështjes janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj). Gjatë procedurës së hetimit administrativ është kontaktuar subjekti rivlerësues, nëpërmjet adresës elektronike të deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetësori i përgatitur nga Komisioni, si dhe komunikime të tjera në vijim. Këta pyetësorë janë administruar në dosjen e rivlerësimit të subjektit Manjola Bejleri.

5. Në datën 27.9.2021, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Manjola Bejleri, bazuar në tri kriteret e vlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj dhe, në vijim, paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit. Këto dokumente u administruan në formën e paraqitur nga subjekti dhe u bënë pjesë e dosjes së rivlerësimit.

7. Trupi gjykues, në vijim, në datën 12.10.2021, ftoi subjektin e rivlerësimit Manjola Bejleri, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, në seancë dëgjimore, në datën 18.10.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 18.10.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, por kërkoi të kishte edhe një përfaqësues ligjor, z. E. Xh. (djali i subjektit), i cili paraqiti shpjegime lidhur me analizën financiare të Komisionit dhe rezultatin e hetimit lidhur me të. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues përfundoi procesin e rivlerësimit, për subjektin rivlerësues Manjola Bejleri në seancën e datës 20.10.2021, ku subjekti ishte prezent, me shpalljen e vendimit.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit*, si dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indice* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) raportin e dorëzuar në Komisionit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) dokumente shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaramet të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht; si dhe
- e) denoncimet nga publiku.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Subjekti i deklaramet ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

13.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurisë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaramet të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

14. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të vërtetuar saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, u krye analiza e të dhënave të deklarameteve periodike vjetore në ILDKPKI, deklaramet së pasurisë për procesin e rivlerësimit, si dhe përpunimi, rakordimi dhe vlerësimi i informacioneve të ardhura nga institucionet përkatëse për këtë subjekt.

15. Nga verifikimi dhe vlerësimi i deklaramet *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri, kanë rezultuar pasuritë e paraqitura në vijim.

**16. Pasuria apartament me sip. 104 m<sup>2</sup> (nga e cila 91 m<sup>2</sup> janë sipërfaqe banimi), në rrugën “\*\*\*”, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.** Vlera: 41,440 (dyzetë e një mijë e katërqind e dyzetë mijë) USD. Pjesa takuese: 100%.

16.1 Burimi i krijimit: (i) hua në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD e marrë *cash* nga vëllai A. B., pa afat; (ii) kredi në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) USD, në ish-Bankën Tregtare Greke.

16.2 Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë konfirmon për Komisionin<sup>2</sup> këtë pasuri të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, e cila është rivlerësuar në datën 19.5.2017, në vlerën 13,195,000 (trembëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë. Kjo pasuri rezulton e bllokuar në favor të “Alpha Bank”, për shumën 100,000 euro (njëqind mijë) me datë regjistrimi 16.3.2018, në bazë të Kontratës së Hipotekës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.3.2018.

16.3 Komisioni bëri një përlllogaritje, lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, duke e krahasuar me çmimet sipas referencave të Entit Kombëtar të Banesave.

<sup>1</sup>Procedura e vlerësimit të pasurisë 1, ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaramet dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.

<sup>2</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2020, e ASHK-së Tiranë.

Pasuria apartament me sip. 104 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2003, në vlerën 41,440 (dyzetë e një mijë e katërqind e dyzetë) USD (ekuivalent në lekë në vlerën 4,504,114 lekë) rezulton më e ulët se çmimi i referencës sipas EKB-së për vitin 2003, sipas të cilit çmimi mesatar i tregut të lirë për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Tiranës përlllogaritët rreth 5,558,800 (pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë (pa marrë në konsideratë zonën preferenciale ku ndodhet pasuria).

16.4 Komisioni kreu analizën e burimit të të ardhurave të përdorura për blerjen e apartamentit nga e cila rezultoi sa vijon.

**i) Hua në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, nga shtetasi A. B.**

16.5 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2003 marrjen e huas në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD nga vëllai, me banim në Sydney, Australi, për blerje apartament banimi. Në deklaratën *Vetting* subjekti e deklaroi këtë hua si detyrim të pashlyer. Subjekti nuk e deklaroi këtë hua si detyrim ndër vite.

16.6 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur<sup>3</sup> nga Komisioni lidhur me mosshlyerjen e kësaj huaje, ndër vite, nisur edhe nga fakti i rezultuar gjatë hetimit se gjendja financiare në llogaritë bankare të deklaruara prej saj e tejkalonte disa herë vlerën e huas, shprehet se: *“Meqenëse vëllai im A. B. nuk e kishte domosdoshmëri kthimin e kësaj shume, pasi ka pasur dhe ka të ardhura të larta të siguruara nga puna në Australi dhe, për rrjedhojë, një gjendje shumë të mirë ekonomike, e kemi lënë në marrëveshje e mirëkuptim me njeri-tjetrin, që huan t’ia shlyej kur ta shoh unë të arsyeshme, në një moment më të përshtatshëm për mua”*.

16.7 Subjekti është pyetur<sup>4</sup> lidhur me mënyrën se si e ka marrë këtë shumë prej vëllait të saj që jetonte në Australi, e cila në vijim deklaroi: *“Më hollësisht, shpjegoj se këtë shumë ma ka dhënë cash në muajin Qershor të vitit 2002 kur ai ka qenë në Shqipëri së bashku me familjen e tij. Meqenëse kontrata për ndërtimin e apartamentit u mundësua në fillim të vitit 2003 dhe huaja u përdor po në këtë vit, edhe deklarimi i kësaj huaje është bërë në vitin 2003, kur edhe hyri në fuqi ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’”*. Për këtë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\*, datë 24.1.2020, në shtetin e Australisë, ku shtetasi A. B. deklaroi dhënien e huas *cash*, pa shpërblim në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, në vitin 2002.

16.8 Lidhur me mundësitë financiare të shtetasit A. B., për dhënien e kësaj huaje, subjekti ka paraqitur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\*, të datës 24.1.2020, nga shteti i Australisë, të shtetasit A. B., i cili deklaroi dhënien e huas *cash*, duke deklaruar si burim të saj të ardhurat që prej përfundimit të studimeve universitare në vitin 1992, kryesisht nga puna në emigracion në periudhat kohore: 2.12.1994 – gusht 1995, në SHBA; 18.4.1996 – 25.6.1996, në Kanada; nëntor 1996 – gusht 1997, në Greqi; si dhe nga nëntori i vitit 1999 si rezident i përhershëm dhe shtetas australian.

16.9 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë shumë, ndër vite, si detyrim të pashlyer, por e deklaroi vetëm në deklaratën *Vetting*. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar hua nga vëllai A. B., me banim në Australi, prej vitit 2000 dhe në deklaratën *Vetting* nuk e ka deklaruar, sipas detyrimit që ka pasur në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, e cila, për më tepër, ende sot rezulton me burim pikërisht këto të ardhura.

16.10 Subjekti ka paraqitur dokumentacionin mbi të ardhurat e vëllait në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si dhe në pyetësorët në vijim.

16.11 Për Komisionin nuk rezultoi e provuar mundësia financiare e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, shtetasin A. B., për dhënien hua të shumës së deklaruar prej saj. Nga vlerësimi i dokumentacionit nuk rezultuan të dhëna mbi të ardhurat e këtij shtetasi, për

<sup>3</sup>Shihni përgjigjen nr. 6, në pyetësorin e datës 16.3.2021.

<sup>4</sup>Shihni përgjigjen nr. 1, në pyetësorin e datës 16.3.2021.

periudhën 2000 – 2002, në Australi (referuar deklaramit të vitit 2003 të bërë nga subjekti i rivlerësimit). Po ashtu, edhe nga dokumentacioni i paraqitur në tërësi, për të gjithë kohën e punësimit të shtetasit A. B., nuk rezultoi e provuar mundësia e tij financiare për të dhënë hua në shumën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, referuar kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

16.12 Në vijim, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë këtë burim si të ardhur në analizën financiare të vitit 2003. Po ashtu, e paprovuar mbetet për Komisionin edhe mënyra se si i është dhënë shuma subjektit të rivlerësimit.

16.13 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD të përdorur për krijimin e kësaj pasurie, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

#### **ii) Kredi në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) USD, në Bankën Tregtare Greke**

16.14 Referuar Kontratës së Huas nr. \*\*\*, datë 25.6.2003, mes Bankës Tregtare Greke dhe palës huamarrëse Manjola Bejleri, dorëzanës shtetasit U. B., N. B., A. B. dhe Manjola Bejleri, subjekti rivlerësimi ka përfituar shumën 30,000 (tridhjetë mijë) USD. Kjo hua është disbursuar në datën 2.7.2003, në vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) USD.

16.15 Kredia është shlyer rregullisht sipas kontratës për vitet 2004 – 2006 dhe në datën 26.2.2007 është kryer shlyerja totale e saj në shumën e mbetur prej 23,105 (njëzetë e tre mijë e njëqind e pesë) USD.

16.16 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shlyerja e vlerës së kredisë prej 30,000 (tridhjetë mijë) USD është kryer deri në vitin 2007, me burim:

- a- Të ardhurat nga paga si gjyqtare, për periudhën 2003 – 2007, për pagimin e kësteve mujore.
- b- Hua *cash*, në shumën 1,000,000 (një milion) lekë, në datën 20.2.2007, nga vëllai F. B. pa afat, e shlyer me këste deri në datën 9.9.2014.
- c- Shuma 1,000,000 (një milion) lekë është përfituar nga shitja e pjesës takuese prej 1/4 në apartamentin e banimit me sip. 79.9 m<sup>2</sup>.
- ç- Shuma 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë marrë nga shitja e automjetit tip “Volkswagen (Golf 2)”, prodhimi i vitit 1986, me targa \*\*\*.

16.17 Duke analizuar të ardhurat e përfituara **në shumën 1,000,000 (një milion) lekë, marrë nga shitja e pjesës takuese prej 1/4 e apartamentit të banimit me sip. 79.9 m<sup>2</sup>, më 20.11.2007, ka rezultuar si vijon:**

16.18 Pasuria apartament me sip. 79.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me vlerë 25,376 (njëzetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, me pjesë takuese ¼, është tjetërsuar në datën 20.11.2007.

16.19 Në DIPV-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi se së bashku me vëllain A. B., në datën 20.11.2007, ia kanë shitur pjesën përkatëse takuese në këtë apartament prej ¼ secili, në shumën 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vëllait tjetër F. B.. Subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi në deklaratën periodike vjetore, të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, si burim për shlyerjen e kredisë. Po ashtu, ajo nuk deklaroi lidhur me vlerën e përfituar prej saj.

16.20 Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.11.2007, të 4 bashkëpronarët ia kanë shitur këtë apartament shtetasit F. B. në vlerën 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Sipas kontratës kjo vlerë është likuiduar tërësisht dhe njëherësh nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Në këtë kontratë shtetasi A. B. rezultoi i përfaqësuar me prokurë nga shtetasja N. B.. Në këtë kontratë është parashikuar se shitësit U. B. dhe N. B. do të jetojnë në këtë apartament deri në fund të jetës së tyre.

16.21 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga shitja e kësaj pasurie ka përfituar shumën 1,000,000 (një milion) lekë. Subjekti i rivlerësimit, e pyetur nga Komisioni<sup>5</sup>, lidhur me përfitimin e shumës 1,000,000 (një milion) lekë në raport me ¼ pjesë në këtë pasuri, deklaroi se: *“Sqaroj se siç del dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate, kalimi i pronësisë është bërë në këtë mënyrë: dy nga bashkëpronarët U. B. (babai) dhe N. B. (nëna) në fakt ia kanë dhuruar pa kundërshpërblim pjesët e tyre takuese vëllait F. B.. Ndërsa dy bashkëpronarët e tjerë, A. B. (vëllai) dhe unë Manjola Bejleri, pjesët tona takuese i kemi shitur me kundërshpërblim. Sqaroj se ky ka qenë edhe shkaku që në përmbajtjen e kontratës së shitjes është vënë kushti: ‘Shitësit U. B. dhe N. B. do të jetojnë në këtë apartament deri në fund të jetës së tyre. Fakti i dhurimit të dy pjesëve takuese të prindërve dhe se sa të holla mori secili nga shitja nuk janë përmendur në kontratë. Është i vërtetë fakti se pjesa ime takuese ka qenë 1/4, por çmimi i shitjes që unë i kam vënë pjesës time takuese dhe që është pranuar dhe nga blerësi ka qenë 1,000,000 lekë. Të njëjtin çmim (pothuajse, me diferencë vetëm 50,000 lekë më pak) ka vënë edhe shitësi tjetër A. B., i cili kishte po 1/4 pjesë takuese”*.

16.22 Lidhur me deklarimin e subjektit në deklaratën *Vetting* se shuma 1,000,000 (një milion) lekë, me burim nga shitja e apartament banimit me sip. 79.9 m<sup>2</sup>, është përdorur për shlyerjen e kredisë, nuk përputhen me situatën reale të pronësisë, si dhe me kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie në datën 20.11.2007 dhe kontratën për mbylljen e kredisë datë 26.2.2007. Po ashtu as me deklaratimet e vetë subjektit në DPV.

16.23 Duke analizuar të ardhurat e përfituara si hua në shumën 1,000,000 lekë (një milion), marrë te shtetasi F. B., ka rezultuar si vijon.

16.24 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se i ka marrë hua vëllait F. B. shumën 1,000,000 (një milion) lekë *cash*, të cilën e ka përdorur si burim për shlyerjen para kohe të kredisë bankare.

16.25 Në DIPV-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen hua të shumës 1,000,000 (një milion) lekë nga vëllai F. B., pa kontratë, për shlyerjen e kredisë. Subjekti ka deklaruar vetëm këtë burim të ardhurash për shlyerjen e kredisë para afati. Subjekti e deklaroi këtë hua si detyrim në vitet në vijim.

16.26 Në DIPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi: shlyerjen e shumës 800,000 (tetëqind mijë) lekë, të përfituar prej tërheqjes së depozitës në shumën 500,000 (pesëqind mijë) lekë në “Raiffeisen Bank”, në datën 14.9.2011; tërheqjen nga të ardhurat nga paga në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë më 14.9.2011; si dhe tërheqje të tjera që përbëjnë shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë në “Credins Bank”.

16.27 Në DIPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi shlyerjen e pjesës së mbetur në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë të kësaj huaje në datën 9.9.2014 nga depozita e tërhequr në “Credins Bank”.

16.28 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e kësaj huadhënieje. Duke qenë se ishte shlyer tërësisht në vitin 2014, Komisioni verifikoi deklaratat periodike vjetore, lidhur me burimin e kësaj huadhënieje, nga ku, gjithashtu, nuk rezultuan të dhëna.

16.29 Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, lidhur me mundësitë financiare dhe të ardhurat e ligjshme të vëllait për dhënien e kësaj huaje, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si vijon: (a) të ardhurat në total në vlerën 2,836,684 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë të përfituara në vitet 1999 – 2006, nga puna në organizatat jofitimprurëse “\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”; (b) të ardhurat *neto* në vlerën 241,678 (dyqind e dyzetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë të përfituar në vitin 2004 nga Shkolla e Magjistraturës; dhe (c) të ardhurat *neto* në vlerën 471,923 (katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzetë e tre) lekë të përfituara, në periudhën mars – nëntor 2007, si punonjës në “Raiffeisen Bank”.

<sup>5</sup>Shihni përgjigjen nr.1, në pyetësorin e datës 6.3.2020.

16.30 Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur ka rezultuar se për të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës janë paguar detyrimet përkatëse tatimore dhe sigurimet shoqërore. Të ardhurat nga puna në organizatat jofitimprurëse “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*” nuk rezultojnë të deklaruar pranë organeve tatimore dhe as vetë shtetasi F. B. i regjistruar në sigurimet shoqërore. Të ardhurat si punonjës në “Raiffeisen Bank”, provohet përfitimi i tyre, pagesa e detyrimeve tatimore apo sigurimeve shoqërore referuese.

16.31 Komisioni përgatiti një analizë financiare, duke llogaritur të ardhurat e njohura, nga e cila rezultoi se për periudhën 1999 – janar 2007, janë në total në shumën 241,678 (dyqind e dyzetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, ndërkohë shuma e dhënë hua në shkurt të vitit 2007 rezulton në vlerën prej 1,000,000 (një milion) lekësh. Nga dokumentacioni i përcjellë duket se vëllai i subjektit, shtetasi F. B., nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore, që të japë huan në shumën 1,000,000 lekë (një milion), në datën 20.2.2007.

16.32 Duke analizuar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa \*\*\*, në shumën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si burim për shlyerjen e kredisë, rezulton se ky automjet është shitur me Kontratë Shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.5.2007. Likuidimi i huas është bërë në datën 26.2.2007, me të ardhura nga derdhje *cash* e shumës 22,910 (njëzetë e dy mijë e nëntëqind e dhjetë) USD.

16.33 Në DIPV-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi si burim për shlyerjen e kredisë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, por vetëm huan e marrë nga vëllai i saj, shtetasi F. B..

16.34 Deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* se shuma 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me burim nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, është përdorur për shlyerjen e kredisë, nuk përputhet me situatën reale, pasi kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie është realizuar në datën 18.5.2007 dhe kontrata për mbylljen e kredisë në datën 26.2.2007.

16.35 Në vijim, Komisioni ka përgatitur analizën financiare, lidhur me mundësitë financiare të subjektit për shlyerjen e kredisë në datën 26.2.2007, në të cilën rezulton në pamundësi financiare në vlerën 1,483.514 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë.

16.36 Komisioni nuk ka marrë në konsideratë si burim për shlyerjen e kredisë deri në këto momente: (a) huan e dhënë *cash* nga shtetasi F. B., në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë; (b) të ardhurat nga shitja e pjesës ¼ të apartamentit me sip. 79.9 m<sup>2</sup>; (c) të ardhurat nga shitja e automjetit.

#### Analizë financiare

<i>Shlyerja e kredisë</i>	26.2.2007
<i>Shlyerje e kredisë</i>	- 1.895.824
<b>Hua nga F. B., datë 20.2.2007</b>	0
<b>Pakësime likuiditeti në bankë</b>	-359.063
<i>Pasuria neto</i>	<b>1.536.761</b>
<i>Të ardhura të dokumentuara</i>	<b>147.226</b>
<b>Të ardhura nga paga</b>	141.226
<b>Të ardhura nga ish-bashkëshorti për fëmijën</b>	6.000
<b>Të ardhura nga shitja e automjetit (shitur më 18.5.2007)</b>	0
<b>Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 79.9 m<sup>2</sup> (shitur më 20.11.2007)</b>	0
<i>Shpenzime</i>	<b>93.979</b>
<b>Shpenzime jetese</b>	45.540
<b>Shpenzime për kredinë/interesa</b>	48.439

16.37 Në përfundim lidhur me këtë pasuri rezulton se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003, pasi deri në këtë moment të ardhurat në shumën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, të deklaruara si të dhëna hua prej vëllait A. B., nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni dhe subjekti duhet të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit.
- b) Duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamjaftueshmëri financiare me të ardhura të ligjshme sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për likuidimin e vlerës së kredisë prej 23,105.23 (njëzetë e tre mijë e njëqind e pesë) USD, ndaj bankës, në datën 26.2.2007, në vlerën -1.483.514 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë.

16.38 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

16.39 Në vijim, nëpërmjet prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “*Sqaroj se në zonën ku ndodhet apartamenti sa sipër dhe në kohën kur është lidhur kontrata në prill të vitit 2003, çmimi prej 510 USD/m<sup>2</sup> ishte një çmim i tregut të lirë dhe aspak i ulët. Madje është më i lartë se çmimi/m<sup>2</sup> që ju i referoheni në rezultatet e hetimit. Gabimi i bërë në përlllogaritjen tuaj në këtë rast është se nuk keni marrë aspak parasysh faktin që ky apartament ka një sipërfaqe prej 33 m<sup>2</sup> verandë + 13 m<sup>2</sup> shkallë = 46 m<sup>2</sup>, sipërfaqe që përlllogariten me gjysmën e çmimit të sipërfaqes së brendshme”.*

- ***Lidhur me huan në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD***

Subjekti, në prapësime, në lidhje me këtë hua, shpjegon se: “*Të gjitha udhëtimet e largëta që ka kryer vëllai A. B. në të gjitha kontinentet sa sipër, të cilat kanë qenë të gjitha me dokumente të rregullta dhe të ligjshme (si për lëvizjen me viza edhe për vendqëndrimin e punësimit), tregojnë qartazi që vëllai im kishte mundësi shumë të mira ekonomike për t’i përballuar. Referuar kohës për të cilën bëhet fjalë (1993 – 2003), një periudhë shumë e vështirë tranzicioni për vendin tonë (migrimi masiv për arsye politike, ekonomike, trazirat e 1997 etj.), realizimi i lëvizjeve në largësi të tilla, me viza të rregullta dhe me leje qëndrimi e punësimi, ishte mundësi për një numër të vogël personash, në raport me popullsinë. Ky fakt tregon qartazi që vëllai im kishte mundësi shumë të mira ekonomike për t’i përballuar udhëtime të tilla. Kjo është një provë tjetër indirekte që provon se vëllai im A. B. e kishte në atë kohë mundësinë për të më dhënë mua huan prej 12,000 USD.*

*Në mbështetje të deklarimeve të vëllait tim A. B. mbi periudhën e punësimit të tij në Australi, sjell një tabelë informuese historike nga faqja Wikipedia.org mbi pagën minimale në shtetin australian për periudhën 2000 – 2003 (periudhë që ai provohet se ka qenë i punësuar në Australi). Këtë informacion e sjell për të bërë qoftë dhe një krahasim me këtë lloj page (minimale), lidhur me të ardhurat e tij në këtë periudhë, e cila provon edhe në këtë rast, se ai kishte mundësi për të kursyer shumën e dhënë mua hua prej 12,000 USD. Burimi: [https://en.wikipedia.org/wiki/Minimum\\_wage\\_law#Australia](https://en.wikipedia.org/wiki/Minimum_wage_law#Australia).*

*Theksoj faktin se vëllai nuk ka punuar asnjëherë me pagë minimale, pasi ka qenë i punësuar si inxhinier elektrik. Ky fakt provohet dhe dokumentin shkresor nënshkruar nga drejtori i kompanive ‘\*\*\*’ dhe ‘\*\*\*’ z. N. Ch., ish-punëdhënës i A. B., për periudhën e viteve 2000 – 2003, në Australi, të cilin e paraqes në cilësinë e provës.*

*Për sa i përket dokumentacionit tjetër që ju kërkoni sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sqaroj se për shkak të hapësirës shumë të largët kohore (mbi 25 vjet) dhe të mosparashikimit në atë kohë të procesit të rivlerësimit që po ndodh sot, në kuptim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, jemi në pamundësi për të paraqitur prova të tjera tej atyre të sjella, të tilla që përcaktohen në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.*



*Për më tepër, vërej se ish-punëdhënësit e vëllait tim të asaj periudhe gjenden në shtete e kontinente të ndryshme (SHBA, Kanada, Australi dhe Greqi) dhe është e pamundur gjetja e vendndodhjes apo kontaktit të tyre të sotshëm, të dhëna mbi pagesat e kryera, pagesa e detyrimeve tatimore prej tyre etj., të kryera para 25 vjetësh. Përmend këtu se si legjislacioni ynë vendas, ashtu edhe ai australian përcakton ruajtjen e dokumentacionit tatimor deri në 5 vitet e fundit të deklarimit.*

*Gjithashtu, në zbatim të nenit 32/3 të ligjit nr. 84/2016, nga vëllai im është paraqitur si dokument provues dokumenti nga Zyra e Taksave pranë Qeverisë Australiane, që tregon shumën e akumuluar dhe të taksuar në llogarinë e A. B. prej 226,185.09 USD në 'Fondin Q Super'. Siç shpjegohet dhe nga vetë ai, dokumenti tregon shumën e akumuluar në llogarinë e tij gjatë të gjithë kohës që ka punuar në Australi (nëntor 1999 - 2020).*

*Për sa i përket mënyrës se si është dhënë kjo shumë, e kam sqaruar hollësisht edhe në përgjigjet e mëparshme, se kjo shumë është dhënë "cash" nga vëllai im në kushtet e një marrëdhënie të afërt familjare. E njëjta gjë provohet dhe nga deklaratimet e dhëna nga vëllai im".*

- ***Në lidhje me kredinë në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) USD***

*Subjekti në prapësime, vijon të shpjegojë se: "Në kontratë nuk thuhet as që secili nga bashkëpronarët morën 1/4 e çmimit total në vlerën 1,950,000 lekë. Në kontratë thuhet vetëm se ky çmim deklarohet nga shitësit se është paguar më parë jashtë zyrës noteriale. Nga ne bashkëpronarët u veprua thjeshtë me një kontratë shitje, pasi nga të gjitha palët kontraktore kishte harmoni dhe mirëkuptim të plotë për gjithë veprimin që po kryhej. Është i vërtetë fakti se pjesa ime takuese ka qenë 1/4, por çmimi i shitjes që unë i kam vënë pjesës time takuese dhe që është pranuar dhe nga blerësi ka qenë në 1,000,000 lekë. Të njëjtin çmim (pothuajse, me diferencë vetëm 50,000 lekë më pak) ka vënë edhe shitësi tjetër A. B., i cili kishte po 1/4 pjesë takuese.*

*Përveç sa sipër, një fakt tjetër domethënës është edhe vetë çmimi i shitjes së apartamentit. Një apartament i tillë 3+1, me sip.79.9 m<sup>2</sup>, në atë vendndodhje dhe në vitin 2007, nuk mund të kishte një vlerë totale prej 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.*

*Në këto deklarime provohen faktet se:*

*Kam përfituar si të ardhur nga shitja e apartamentit shumën 1,000, lekë. Kjo shumë më është dhënë cash nga vëllai F. B. përpara mbylljes së kredisë (pasi po të mos mbyllej kredia nuk mund të bëhej zhblllokimi në hipotekë dhe shitja e apartamentit).*

*Dy prindërit e mi N. B. dhe U. B. ia kanë tjetërsuar pjesën e tyre takuese vëllait F. B. pa shpërblim, me kushtin që do të vijonin të jetonin aty deri në fund të jetës së tyre.*

*Në lidhje me deklarin tuaj se e ardhura në shumën 1,000,000 lekë e përdorur nga unë për shlyerjen e kredisë, nuk përputhet me kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie dhe kontratën për mbylljen e kredisë, sqaroj se:*

*Siç është përmendur edhe më sipër, kontrata e shitjes së apartamentit ndaj vëllait tim F. B. nuk mund të realizohej nëse unë nuk do të shlyeja më parë tërësisht kredinë e mbetur dhe, si rrjedhojë, të zhblllokohej pasuria nga barra e vënë në favor të bankës për kredinë.*

*Pra, sa më sipër, rezulton qartë se kontrata e shitjes, faktikisht dhe ligjërisht, nuk mund të realizohej pa u shlyer më parë e gjithë kredia në bankë. Fakti që shlyerja është bërë para hartimit të kontratës shitjes rezulton i deklaruar qartë nga vetë noterja, e cila thotë se çmimi i shitjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, në kontratë deklarohet dhe fakti tjetër se prona ishte e lirë nga çdo barrë dhe hipotekë, që vërtetohet me kartelën e pasurisë, datë 19.11.2007, të ZVRPP-së Tiranë, bashkëlidhur kontratës së shitjes.*

*Pra, sa më sipër, logjikisht rezulton qartë se nuk kemi të bëjmë me mospërputhje të situatës reale të pronësisë dhe as me mospërputhje të kontratës së shitblerjes me kontratën për mbylljen e kredisë, pasi faktet nuk mund të ndodhnin ndryshe kronologjikisht përveçse siç kanë ndodhur dhe u shpjeguan më sipër.*

Si rrjedhë, kërkohet që në analizën financiare të hartuar nga ju të pasqyrohet si e ardhur nga shitja e apartamentit me sip.79.9 m<sup>2</sup> vlera e plotë e përfituar nga unë prej 1,000,000 lekësh”.

- **Lidhur me huan në shumën 1,000,000 (një milion) lekë nga vëllai F. B.**

Subjekti në prapësime shpjegon se: “Nga ana juaj nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e shtetasit F. B. të përfituara nga puna në shumën prej 2,836,684 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, për vitet 1999 – 2006, në organizatat jofitimprurëse ‘\*\*\*’ dhe ‘\*\*\*’, pasi deri në këto momente nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore.

Lidhur me detyrimet tatimore, në nenin 18 ‘përrjashtimet’, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, përcaktohet se: ‘Përrjashtohen nga tatimi mbi fitimin: (d) personat juridikë që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre’.

Organizatat jofitimprurëse ‘\*\*\*’ dhe ‘\*\*\*’ janë OJF që kanë ushtruar dhe vazhdojnë të ushtrojnë veprimtari jofitimprurëse vetëm me karakter fetar, humanitar, bamirës dhe edukativ dhe, si rrjedhë, në zbatim të dispozitës sa sipër janë të përrjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Ndërsa tatimi mbi të ardhurat nga pagat e punonjësve është një detyrim që paguhet nga punëdhënësi pranë organeve tatimore dhe jo nga punëmarrësi.

Referuar legjislacionit tatimor, tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin dokumentacionin bazë tatimor, i cili mbahet siç përcaktohet në ligjin ‘Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare’, në ligjin ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’ dhe në udhëzimin në zbatim të tij, ligjin ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ dhe ta ruajnë atë për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit ushtrimor në të cilin ato janë lëshuar.

Po, në datën 11.10.2021, organizata ‘\*\*\*’ i ka kthyer përgjigje me e-mail në të cilin citohet se: ‘Në lidhje me kërkesën tuaj për pajisjen me një vërtetim për pagimin e detyrimeve tatimore, ndërsa rikonfirmoj edhe njëherë punësimin tuaj te ‘\*\*\*’, për periudhën 1999 – 2000, si dhe vërtetimin e lëshuar nga ne, ju bëj me dije se e kemi të pamundur të të japim vërtetim me shkrim për pagesat e detyrimeve tatimore nga paga juaj. Periudha 1999 – 2000 është një periudhë shume e largët dhe nuk disponojmë doku meta të ruajtura për pagesat e tatim taksave. Në bazë të ligjit shqiptar për ruajtjen e dokumentacionit financiar ‘\*\*\*’ ka detyrimin të ruajë atë deri 5 vjet’.

Për punëdhënësin ‘\*\*\*’, ndodhemi në kushtet e zbatimit të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi jemi në pamundësi për të paraqitur prova të tjera tej atyre të sjella, të tilla që përcaktohen në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, për shkak të kohës së largët prej 21 vjetësh më parë. Si rrjedhë, është e pamundur gjetja e të dhënave mbi pagesat e kryera prej tyre për detyrimet tatimore të kryera para 21 vjetësh.

Bazuar në provat e paraqitura që disponohen nga ju dhe në dispozitën ligjore sa sipër, duhet të vlerësohen si të ardhura me burim të ligjshëm shuma e përfituar nga vëllai im F. B. prej 3,755,623 lekësh. Përrfshirja edhe e kësaj shume të ardhurat e tij nga puna, justifikon mundësinë e pagimit të çmimit të shitjes së apartamentit prej 1,000,000 lekësh dhe të dhënies hua ndaj meje të shumës prej 1,000,000 lekësh për shlyerjen e kredisë, në total të shumës prej 2,000,000 lekësh.

Gjithashtu, dua të sqaroj një fakt në lidhje me pagimin e pjesës takuese të çmimit të shitjes prej 950,000 lekësh të vëllait A. B. nga blerësi F. B.. Kjo vlerë nuk i është dhënë vëllait A. B. në vitin 2007, kur është realizuar shitja, pasi ky i fundit nuk ndodhej në Shqipëri, por në Australi.

Si rrjedhë, në tabelën e analizës financiare të hartuar nga ju për F. B., për periudhën 1999 – nëntor 2007, duhet vendosur si shpenzim për blerje apartamenti vetëm shuma prej 1,000,000 lekësh që më është dhënë mua dhe jo në total shuma e shitjes prej 1,950,000 lekësh, pasi shuma 950,000 lekë nuk është paguar në këtë periudhë.

*Për sa më sipër, kërkoj që të merret për bazë në përllogaritjen e të ardhurave me burim të ligjshëm të vëllait tim im, F. B., shuma prej 3,755,623 lekësh me të ardhurat e përfituara nga puna e tij në vitet 1999 – 2006, në organizatat jofitimprurëse ‘\*\*\*’ dhe ‘\*\*\*’, si dhe shuma 1,803,285 lekë me të ardhurat e përfituara nga puna e tij pranë Shkollës së Magjistraturës, ‘Raiffeisen Bank’, ‘\*\*\* (\*\*\*)’ dhe 2 llogari kursimi në ‘Alpha Bank’.*

*Gjithashtu, te tabela e analizës financiare të F. B.t, për periudhën 1999 – nëntor 2007, duhet të zbritet shuma prej 950,000 lekësh, për vitin 2007, pasi kjo shumë nuk i është shlyer vëllait A. B. në këtë vit, por në vitin 2018, që provohet në deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2021, nga F. B., me notere N. Z. Xh. dhe deklaratë e firmosur në prani të ‘Justice of The Peace’, datë 8.10.2021, nga A. B.’.*

16.40 Në vijim, trupi gjykues, pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, dokumentacionin provues bashkëlidhur, arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit për këtë pasuri dhe rezulton në pamundësi financiare në vlerën 1,304,280<sup>6</sup> (një milion e treqind e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2003 dhe në pamundësi financiare në vlerën 1.483.514 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërmëdhjetë) lekë, për likuidimin e kredisë në shkurt të vitit 2007.

16.40.1 Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në vlerën 41,440 (dyzetë e një mijë e dyzetë e katër) USD në vitin 2003, trupi gjykues ka vlerësuar se nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës për këtë çështje, si dhe, në vijim, të arsyetimeve të bëra nga subjekti vlerëson se ato nuk qëndrojnë, pasi çmimi i referuar nga Komisioni është çmimi referencë i tregut të lirë për sipërfaqe shfrytëzimi të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe pa marrë në konsideratë zonën preferenciale ku ndodhet pasuria. Vetë subjekti nuk ka paraqitur ndonjë foto të apartamentit për të vlerësuar pretendimet e saj lidhur me sipërfaqen reale të apartamentit dhe as në kontratë nuk ka pasur klauzola për çmime të diferencuara, por vetëm një sipërfaqe totale të pasurisë.

16.40.2 Lidhur me huan e dhënë nga vëllai A. B. në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, në vitin 2002, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka provuar me ndonjë dokument se vëllai i saj ka qenë në Shqipëri në vitin 2002 dhe as që ai ka pasur mundësi financiare dhe të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj shume hua deri në vitin 2002. Subjekti ka sjellë dokumentacion provues për të ardhurat e shtetasit A. B. në Australi, të cilat japin të dhëna për periudha të mëvonshme (pas dhënies së huas). Dokumentet e paraqitura si provë për periudhën deri në dhënien e huas nuk japin informacion që mund të vlerësohet se ka pasur të ardhura të mjaftueshme e në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka ndryshuar deklaratimet e saj lidhur me burimin e të ardhurave të vëllait, të përdorura për dhënien e huas dhe, po ashtu, nuk ka plotësuar kërkesat e nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, në plotësimin e deklaratës *Vetting*, duke dështuar në përmbushjen e detyrimit ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënësit në momentin e dhënies së huas. Nga vlerësimi i deklaratimeve periodike vjetore, si e vetmja provë në administrim nga Komisioni, për të kryer vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti, nuk rezulton, herët në kohë, asnjë provë mbi ekzistencën e këtij burimi apo mbi përfitimin e kësaj shume, përveçse deklaratimit të bërë në DPV-në e vitit 2003 nga subjekti, e cila e deklaroi këtë hua nga vëllai i saj me banim në Sidney, Australi, prej vitit 2000. Në vijim, subjekti nuk e ka deklaruar këtë detyrim në DPV-të vijuese, por e ripërmend në deklaratën *Vetting* si detyrim i pashlyer. Trupi gjykues nuk e ka marrë këtë shumë në konsideratë në analizën financiare, si burim për krijimin e pasurisë apartament<sup>7</sup> me sip. 91 m<sup>2</sup>, në Tiranë.

16.40.3 Lidhur me burimet e deklaruara për mbylljen e kredisë në shkurt të vitit 2007, trupi gjykues arsyeton sa vijon.

<sup>6</sup>Korrespondente me shumën 12,000 USD.

<sup>7</sup>Ruga ‘\*\*\*’.

a) Lidhur me huan dhënë nga vëllai F. B., në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të përfituara prej tij, për periudhën 1999 – janar 2007, duke marrë në konsideratë ato të ardhura të cilat janë deklaruar pranë organeve tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe që plotësojnë kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, rezultojnë në pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje në shkurt të vitit 2007.

b) Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës takuese në apartamentin e përfituar nga privatizimi me sip. 79.9 m<sup>2</sup> shtetasit F. B., të pretenduara në deklaratën *Vetting* si burim për shlyerjen e kredisë, rezultoi se kjo shitje është kryer disa muaj më vonë, pasi është shlyer kredia nga subjekti rivlerësues, nëpërmjet derdhjes *cash* të shumës.

Lidhur me pretendimin nga subjekti se nuk mund të lidhnin kontratën e shitblerjes me blerësin, pasi kjo pronë ishte e bllokuar nga banka, praktikat bankare kanë treguar se mund të bëhen veprime shitblerjeje pronash, duke u mbartur inskripti i bankës, kur ka dakordësi midis palës blerëse dhe palës shitëse dhe kalimin e fondeve nëpërmjet bankës nga pala blerëse te pala shitëse me qëllim mbylljen e kredisë para afatit. Po ashtu, këto deklaratime të bëra nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, në vijim të rezultateve të hetimit nuk gjejnë ndonjë pasqyrim në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaratimet e saj pas dërgimit të rezultateve të hetimit, duke shtuar se vëllai A. B. nuk e ka arkëtuar pjesën e tij takuese prej 950,000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh nga blerësi F. B., duke deklaruar se kjo shumë është paguar vetëm në vitin 2018, kohë kur shtetasi A. B. ka ardhur me pushime në Shqipëri dhe se ai nuk kishte nevojë. Por, nga sistemi *TIMS* rezultojnë se shtetasi A. B. ka hyrë disa herë në territorin shqiptar para vitit 2018, duke qëndruar për periudha disa mujore në Shqipëri, po ashtu edhe subjekti i rivlerësimit e ka vizituar atë në vitin 2008.

Trupi gjykues krijon bindjen se këto deklaratime të mëvonshme<sup>8</sup> kanë vlerë të kufizuar, pasi rezultojnë si përpjekje për të justifikuar mundësitë financiare të shtetasit F. B., në funksion të përmbysjes së një analize financiare negative. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, duke theksuar marrëdhënien e posaçme që ka me blerësin (vëllain), për dhënien e shumës para se të lidhej kontrata, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues mbi ekzistencën e shumave potencialisht nga vëllai i saj në vitin 2007 (si për dhënien e huas, ashtu edhe për blerjen e pjesës takuese në pasurinë apartament me sip. 79.9 m<sup>2</sup>). Po ashtu, në kontratën e shitblerjes së apartamentit të datës 20.11.2007, citohet saktësisht *se kjo vlerë është likuiduar tërësisht dhe njëherësh nga blerësi jashtë zyrës noteriale*, duke mos dhënë ndonjë detaj që të lidhet me deklaratimet e tanishme të subjektit. As në deklaratat periodike vjetore dhe as në kontratën mes palëve nuk gjenden të dhëna që mund të përputhen me kontekstin e sotëm të deklaratimeve të bëra nga subjekti. Subjekti nuk ka deklaruar në vitin 2007 se ka përfituar nga shitja e apartamentit shumë prej 1,000,000 (një milion) lekësh apo që mund ta ketë përfituar atë paradhënie dhe as që ta ketë përdorur si burim për shlyerjen e kredisë.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se shuma e deklaruar prej 1,000,000 (një milion) lekësh, si burim krijimi për mbylljen e kredisë, nuk duhet marrë në konsideratë<sup>9</sup>.

c) Lidhur me të ardhurat në shumën prej 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh nga shitja e një automjeti, të deklaruar në deklaratën *Vetting*, si burim për shlyerjen e kredisë, rezultoi se kjo pasuri ishte shitur në maj të vitit 2007, pra, në një kohë të mëvonshme nga shlyerja e kredisë. Ky burim nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2007, por vetëm në deklaratën *Vetting* dhe, në vijim, të prapësimeve subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se burimi me të ardhurat nga vëllai F. B. (1,000,000 lekë hua + 1,000,000 lekë nga shitja e pasurisë), mjaftojnë për shlyerjen e kredisë, duke mos dhënë kështu shpjegime për mospërputhjet e konstatuara dhe duke u tërhequr nga ky burim i deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*. Kjo shumë nuk është marrë në konsideratë si burim për shlyerjen e kredisë.

<sup>8</sup>Shihni vendimin e KPA-së për subjektin I. M..

<sup>9</sup>Shihni vendimin e KPA-së për subjektin A. Z.

16.40.4 Trupi gjykues ka vlerësuar se deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për shkak të procesit të saj të rivlerësimit, nuk mundën të prodhojnë besueshmëri dhe se ato nuk përputhen me ndonjë provë apo situatë në deklaratat periodike të kohës apo dokumente të tjera të prodhuara në atë kohë, përveç deklarimeve të subjektit.

16.40.5 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe se rezulton në mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për krijimin e pasurisë dhe ndodhet në kushtet e germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**17. Pasuria apartament me sip. 99.2 m<sup>2</sup>, 2 kate (së bashku me truallin nën të me sip. 57,6 m<sup>2</sup>), në rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*\*, Tiranë. Vlera: 12,110 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë. Pjesa takuese: ¼.**

17.1 Burimi i krijimit: përfituar në bazë të ligjit nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me Kontratën e Shitjes<sup>10</sup>, datë 11.3.1994, nga bashkëpronarët V. Xh., R. Xh., E. Xh. dhe Manjola Xh. (Bejleri).

17.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-të për vitet 2003 dhe 2004. Në DPV-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar zotërimin e 1/5 pjesë në këtë apartament banimi me sip. 99.2 m<sup>2</sup>, në vlerën 11,900 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë, të ndërtuar përpara vitit 1990, të përfituar gjatë martesës, për të cilin kishte marrë dijeni në muajt e fundit.

17.3 Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë konfirmon për Komisionin<sup>11</sup> se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*\*, apartament me sip. 99.2 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, duke dërguar edhe dosjen përkatëse nga e cila ka rezultuar:

a) Ky apartament është i regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve R. Xh., Manjola Xh. (Bejleri), E. Xh., I. Xh. dhe A. Xh..

b) Bazuar në Dëshminë e Trashëgimisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.1.2018, janë përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit E. Xh., I. Xh. dhe A. Xh., duke u bërë edhe veprimet përkatëse.

c) Bashkëpronarët V., E. dhe R. Xh., me cilësinë e porositësit, kanë lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2017, me shoqërinë “\*\*\*\*”, sh.p.k., duke vënë në dispozicion për ndërtim apartamentin me sip. 99.2 m<sup>2</sup>.

ç) Bashkëpronarët V. Xh., R. Xh., E. Xh. dhe Manjola Xh. (Bejleri) kanë privatizuar këtë apartament banimi 3+1, me sip. 99.2 m<sup>2</sup> dhe truallin me sip. 57 m<sup>2</sup>, nga Ndërmarrja Komunale Banesa Nr. \*\*\*\*, duke lidhur Kontratën e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.3.1994, në vlerën 12,110 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë.

17.4 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën fillestare të pasurisë, por e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005, duke u shprehur se kishte marrë dijeni në muajt e fundit.

17.4.1 Duket se subjekti i rivlerësimit ka përfituar 2 herë banesë në zbatim të ligjit nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, përkatësisht ¼ pjesë tek apartamenti i banimit me sip. 79.9 m<sup>2</sup> dhe ¼ pjesë tek apartamenti me sip. 99.2 m<sup>2</sup>.

17.4.2 Duket se subjekti i rivlerësimit është përfituese me pjesë takuese për këtë pasuri në ndërtimin e zhvilluar mbi këtë truall, përfitimin e së cilës nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017.

17.5 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërputhjet e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore.

<sup>10</sup>Kontrata e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.3.1996, dosja e ILDKPKI-së (Aneks 4/5).

<sup>11</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, e ASHK-së Tiranë.

17.6 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet së bashku me pasurinë truall me sip. 112 m<sup>2</sup> (oborr funksional i apartamentit me sip. 99.2 m<sup>2</sup>), në rrugën “\*\*\*\*”. Kjo pasuri shtjellohet në vijim së bashku me pasurinë truall me sip. 112 m<sup>2</sup>.

**18. Pasuria truall me sip. 112 m<sup>2</sup> (oborr funksional i apartamentit me sip. 99.2 m<sup>2</sup>), në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, p. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*. Vlera: 300,000 (treqind mijë) lekë. Pjesa takuese: ¼.**

18.1 Burimi i krijimit të pasurisë në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 28.7.2010, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, “Për tjetërsim të sipërfaqes oborr në përdorim”, për tjetërsimin e sipërfaqes së truallit me sip. 112 m<sup>2</sup>, blerë me çmim 300,000 (treqind mijë) lekë<sup>12</sup>, paguar nga shtetasi R. Xh., në llogarinë bankare të ish-AKKP (sot ATP).

18.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese ¼ për këtë pasuri të përfituar në vitin 2010, por e ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

18.3 Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë konfirmon për Komisionin<sup>13</sup> se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarëve të tjerë R., E., I. dhe A. Xh., figuron e regjistruar në datën 11.10.2010, pasuria me nr. \*\*\*, truall me sip. 112 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, duke dërguar edhe dosjen përkatëse nga e cila ka rezultuar se:

a) Pasuria truall me sip. 112 m<sup>2</sup> është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 11.10.2010, me bashkëpronarë shtetasit V. Xh., R. Xh., E. Xh. dhe Manjola Xh. (Bejleri). Nga dosja e përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>14</sup> rezulton se me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.7.2010, të AKKP-së “Për tjetërsim të sipërfaqes oborr në përdorim”, është vendosur: *“Tjetërsimi me kundërshpërblim i sipërfaqes 112 m<sup>2</sup> të oborrit në përdorim të subjektit R. Xh., V. Xh., E. Xh., Manjola Bejleri (Xh.), ndodhur në rrugën ‘\*\*\*\*’ Tiranë”*.

b) Bashkëpronarët V., E. dhe R. Xh., me cilësinë e porositësit kanë lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2017, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke vënë në dispozicion për ndërtim truallin me sip. 112 m<sup>2</sup>.

c) Me Dëshminë e Trashëgimisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.1.2018, janë përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit E. Xh., I. Xh. dhe A. Xh..

18.4 Komisioni i ka dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar informacion, nëse subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështje me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna.

18.5 Në përfundim të hetimit, lidhur me këtë pasuri, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-të përkatëse të viteve 2010 – 2016. Subjekti duket se është përfituese në pjesë takuese në këtë pasuri, po ashtu edhe në ndërtimin e zhvilluar nga shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., përfitimin e së cilës nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017.

18.6 Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me mospërputhjet e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore.

18.7 Në vijim të prapësimeve, subjekti ka shpjeguar:

○ Në lidhje me pasurinë apartament me sip. 99.2 m<sup>2</sup>: *“Nga provat shkresore rezultojnë faktet: pasuria apartament me sip. 99.2 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese 1/4, është fituar gjatë martesës me Kontratë Shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.3.1994, për çmimin 12.110 lekë, në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’; kontrata e shitjes është regjistruar në hipotekë në datën 29.12.1997; certifikata e parë për vërtetim pronësie është lëshuar në datën 18.2.2003 (shihni të dhënat e pasqyruara në kartelën e pasurisë së datës 27.3.2006, që unë disponoj); të gjitha veprimet për regjistrimin e pasurisë janë kryer nga ish-bashkëshorti R. Xh. gjatë kohës që ne ishim të divorcuar; në DPV-në e vitit 2005 kam deklaruar se: ‘Kjo pasuri është fituar gjatë martesës, për të cilën kam marrë dijeni muajt e fundit’; në*

<sup>12</sup>Fatura për arkëtim në dosjen e ILDKPKI-së (Aneksi 4/6).

<sup>13</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, e ASHK-së Tiranë.

<sup>14</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2017, e ZQRPP-së në dosjen e ILDKPKI (Aneksi 28).

*deklaratën e rivlerësimit të vitit 2017 kam deklaruar për këtë apartament se është: ‘... pasuri e fituar nga martesë me ish-bashkëshortin R. Xh.’”.*

○ Në lidhje me pasurinë truall me sip. 112 m<sup>2</sup> (oborr funksional i apartamentit me sip. 99.2 m<sup>2</sup>): *“Pasuria truall me sip. 112 m<sup>2</sup> (oborr funksional i apartamentit me sip. 99.2 m<sup>2</sup>) me pjesë takuese 1/4 është fituar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.7.2010, ‘Për tjetërsim të sipërfaqes oborr në përdorim’, të AKKP-së (sot ATP). Sipërfaqja e truallit me sip. 112 m<sup>2</sup> është tjetërsuar me çmimin prej 300,000 (treqind mijë) lekësh, paguar nga shtetasi R. Xh. me faturë në llogarinë bankare të ish-AKKP (sot ATP). Për këtë pasuri është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie në datën 11.10.2010, nga ZVRPP-ja Tiranë, si dhe është regjistruar me nr. \*\*\* pasurie, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në rrugën ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, Tiranë. Të gjitha veprimet për regjistrimin e kësaj pasurie janë kryer nga ish-bashkëshorti R. Xh.’”.*

○ Në lidhje me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.: *“Bashkëpronarja tjetër Manjola Bejleri, e cila ka deklaruar se nëse do të binin të gjitha familjet dakord, ajo do të nënshkruante në fund një kontratë sipërmarrje më vete me shoqërinë e zgjedhur prej nesh. Nuk është bërë e mundur që të nënshkruhet kontratë sipërmarrje me shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k., nga të gjitha familjet bashkëpronare të godinës. Për këtë arsye, deri në momentin e nënshkrimit të kësaj deklaratë, nuk ka asnjë leje të dhënë nga organet kompetente dhe asnjë ndërtim të kryer mbi pasuritë e sipërcituara. Këtë fakt e shoqëroj dhe me foto të godinës në momentin e nënshkrimit të deklaratës.*

*Pra sa më sipër, provohet qartësisht se nuk ka ndonjë kontratë sipërmarrje të lidhur nga ana ime me ndonjë shoqëri ndërtuese, nuk ka ndonjë leje ndërtimi të dhënë nga organet kompetente mbi pasurinë sa sipër dhe nuk ka ndonjë ndërtim të kryer mbi të. Si rrjedhojë, nuk ka mungesë deklarami, sa kohë nuk ka ndonjë përfitim nga ana ime”.*

18.8 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti ishin të mjaftueshme dhe të qarta dhe se, në vijim, nuk kanë rezultuar dyshime lidhur me këtë pasuri (apartamentit me sip. 99.2 m<sup>2</sup> dhe truall me sip. 112 m<sup>2</sup>, oborr funksional) të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Trupi gjykues vlerëson, gjithashtu, se subjekti duhet të kishte deklaruar të drejtat e saj të pronësisë mbi truallin nga viti 2010 deri në vitin 2016, si dhe mënyrën e përfitimit të tij, nga të cilat asaj i kanë lindur të drejta dhe detyrime juridiko-civile, të cilat në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, duhet të ishin deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe se ato mund të ishin edhe objekt kontrolli nga organi kompetent i ILDKPKI-së. Trupi gjykues vlerëson se ndodhur në kushtet kur nuk ka rezultuar se pasuria të jetë tjetërsuar, apo të ketë gjeneruar të ardhura, apo të ketë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të tjera, këto pasaktësi nuk shoqërohen me ndonjë nga situatat e parashikuara në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket problematikave të konstatuara pas deklaratës *Vetting*, trupi gjykues nuk i vlerësoi ato për sa kohë nuk i gjeti të lidhura me veprime të kryera gjatë periudhës së rivlerësimit.

**19. Pasuria apartament me sip. 81.40 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*”, p.\*\*\*, shk.\*\*\*, k.\*\*\*, ap.\*\*\*, Fier. Vlera: 15,139 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë) lekë. Pjesa takuese: 1/5.**

19.1 Burimi i krijimit: nga trashëgimia e babait U. B., gjyshërve Z. dhe S. B., si dhe xhaxhait B. B..

19.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, apartament banimi me sip. 81.40 m<sup>2</sup>, në DIPV-në e vitit 2016, në vlerën 15,139 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë) lekë dhe pjesën takuese 1/5.

19.3 Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier konfirmon për Komisionin<sup>15</sup> se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe pesë bashkëpronarëve të tjerë, përkatësisht shtetasve A. B., Z. B., N. B., A. B. dhe F. B., figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 81.40 m<sup>2</sup>,

<sup>15</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2020, e ASHK-së Fier.

z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, duke përcjellë edhe dosjen përkatëse sipas së cilës rezulton se:

a) Apartamenti është përfituar në bazë të ligjit nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me kontratë për privatizim banese, datë 30.8.1993, me palë shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa dhe palë blerëse Z. B. të apartamentit, në vlerën 12,829 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e nëntë) lekë.

b) Me Dëshminë e Trashëgimisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.11.2016, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë së shtetasit U. B., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë: N. B., A. B., Manjola Bejleri dhe F. B..

c) Me Dëshminë e Trashëgimisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.11.2016, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për shtetasit Z. B., S. B. dhe B. B., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë shtetasit U. B., A. B. dhe Z. B..

19.4 Lidhur me këtë pasuri nuk janë konstatuar problematika nga Komisioni.

**20. Pasuri të paluajtshme, në proces regjistrimi, ndodhur në Libohovë**, lagjja “\*\*\*\*”, të regjistruara në regjistrin hipotekor Gjirokastër me nr. \*\*\*, datë 20.12.1996, në emër të shtetasve S. B., U. B., B. B., A. B. dhe Z. B., si vijon: (a) truall me sip. 1,114 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese: 12%; (b) pemishte me sip. 1,168 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese: 12%; (c) tokë djerrë me sip. 240 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese: 12%; (ç) truall me sip. 432 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese: 12%.

20.1 Burimi i krijimit: përfituar në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 1.3.1995, “Për Kthimin dhe kompensimin e pronave”, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Bashkinë Libohovë (ligji nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”). Pasuritë janë në proces regjistrimi, ku subjekti i rivlerësimit përfiton pjesën takuese 12%, si trashëgimtarë ligjorë e babait U. B., gjyshes S. B. dhe xhaxhait B. B. (Dëshmi Trashëgimie Ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.11.2016 dhe Dëshmi Trashëgimie Ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.11.2016).

20.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPV-në e vitit 2016 këto pasuri, të ndodhura në Libohovë, lagjja “\*\*\*\*”, të regjistruara në regjistrin hipotekor Gjirokastër me nr. \*\*\*, datë 20.12.1996, në emër të shtetasve S. B., U. B., B. B., A. B. dhe Z. B., në proces regjistrimi, duke përcaktuar edhe pjesën e saj takuese prej 12%.

20.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI (pjesë e dokumentacionit që shoqëron deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*, Aneks \*\*\*), konstatohet se:

a) Me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.1995, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve në Bashkinë Libohovë, është vendosur që trashëgimtarëve të shtetasit Z. B., përkatësisht shtetasve: S. B., U. B., B. B., A. B. dhe Z. B., ndër të tjera, t’u kthehen pronat si vijon: (a) pemishte me sip. 1,168 m<sup>2</sup>; (b) truall me sip. 1,114 m<sup>2</sup>; (c) tokë djerrë me sip. 240 m<sup>2</sup>; dhe (ç) truall me sip. 432 m<sup>2</sup>, në qytetin e Libohovës.

b) Sipas dokumentit Vërtetim Pronësie, datë 20.12.1996, të Hipotekës Gjirokastër, në regjistrin e transkriptimeve nr. \*\*\*, datë 20.12.1996, në pronësi të shtetasve S. B., U. B., B. B., A. B. dhe Z. B., figurojnë të regjistruara pasuritë: (i) pemishte me sip. 1,168 m<sup>2</sup>; (ii) truall me sip. 1,114 m<sup>2</sup>; (iii) tokë djerrë me sip. 240 m<sup>2</sup>; (iv) truall me sip. 432 m<sup>2</sup>, në qytetin e Libohovës.

20.4 Lidhur me këtë pasuri nuk janë konstatuar problematika nga Komisioni.

**21. Pasuria automjet tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, blerë në vitin 2010, me vlerë 1,000,000 (një milion) lekë**, në pronësi të shtetasit F. B. (vëllai i subjektit), deklaruar në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

21.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi në deklaratën *Vetting* për herë të parë këtë pasuri në përdorim: “Automjet në përdorim pa interes tip ‘Passat’ marka ‘Volkswagen’. Ky automjet përdoret sipas rastit nga vetë pronari F. B., nga Manjola Bejleri dhe E. Xh.”.



21.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, rezulton se shtetasi F. B. ka blerë automjetin me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 8.12.2010, nga shtetasi I. O., në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë.

21.3 Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>16</sup>, lidhur me automjetin me targa \*\*\*, në emër të shtetasit F. B., rezulton se:

a) Sipas dokumentit “leje qarkullimi”, vlera e automjetit është 1,646,284 (një milion gjashtëqind e dyzetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

b) Sipas Deklaratës Doganore të datës 10.11.2010 rezulton se automjeti është importuar nga Italia, nga shtetasi I. O., vlera e automjetit është 7,000 (shtatë mijë) euro dhe detyrimet doganore janë në vlerën 372,780 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, pa përfshirë shpenzime për transport dhe shpenzime të tjera.

21.4 Nga sistemi *TIMS* rezulton se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar disa herë jashtë Shqipërisë me automjetin tip “Volkswagen Passat”. Ndërkohë nga sistemi *TIMS* rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit, i cili është pronar i këtij automjeti, nuk ka udhëtuar asnjëherë jashtë Shqipërisë me këtë automjet, por ka përdorur automjet tjetër.

21.5 Sipas AMF-së, subjekti i rivlerësimit figuron përdoruese e automjetit tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, disa herë edhe djali i saj.

21.6 Nga kërkimi në AMF rezulton se shtetasi F. B., gjatë periudhës 2008 – 2012, është njëkohësisht pronar dhe përdorues i automjetit tip “Mercedes-Benz C250D”, me targa \*\*\*.

21.7 Në përfundim rezulton se shtetasi F. B. ka pasur në pronësi një automjet tjetër, duke sjellë dyshime se automjeti tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, blerë në vitin 2010, mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, nisur edhe nga të dhënat e rezultuara gjatë hetimit mbi përdorimin e këtyre automjeteve përkatësisht. Nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për blerjen këtij automjeti në vitin 2010, në vlerën 569,028 (pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëzetë e tetë) lekë.

21.8 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, lidhur me rezultatin e hetimit dhe dyshimet e ngritura nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri.

21.9 Në vijim të prapësimeve, subjekti ka shpjeguar: *“Sqaroj se ky automjet është përdorur nga unë gjatë periudhës që i përket verifikimit tuaj 2013 –2016, me raste, kur më është nevojitur. Unë nuk kam pasur nevojë gjatë kësaj periudhe për të përdorur automjet për përditshmëri, pasi banesa ime e ndodhur në rrugën ‘\*\*\*’, Tiranë, ku kam jetuar përgjatë gjithë periudhës 2003 –2016, është vetëm 5 minuta në këmbë larg nga vendi i punës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile). Po kështu, edhe institucionet arsimore të djalit tim, për shkak të afërsisë janë aksesuar në këmbë prej tij. Për më tepër, ai gjatë kësaj periudhe ka qenë i mitur, ose pa leje drejtimi për automjet ose pa autorizim përdorimi për këtë automjet.*

*Në lidhje me përdorimin nga ana ime të automjetit ‘Volkswagen Passat’, me targa \*\*\*, nga sistemi TIMS, rezulton se për herë të parë ky automjet është përdorur nga unë në korrik të vitit 2013 për të dalë jashtë shtetit dhe. më pas, në gusht të vitit 2013, qershor të vitit 2014 dhe prill të vitit 2015. Këto fakte konfirmojnë deklaratimet e mia të mëparshme mbi fillimin e përdorimit të këtij automjeti dhe për përdorimin e tij me raste, ashtu siç kam përdorur në ndonjë rast tjetër edhe automjete të tjera që nuk kanë qenë në pronësinë time.*

*Fakti i përdorimit të një automjeti që është në pronësinë e dikujt tjetër, nuk mund të përbëjë provë mbi të cilën mund të ngrihet një dyshim që të plotësojë standardin e ‘dyshimit të arsyeshëm’, e jo më të çojë në dyshimin ‘se mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit’ siç deklarohet nga ju në pikën 7.9 të rezultateve të hetimit. Nuk kam pasur asnjë arsye për ta bërë një gjë të tillë.*

*Ashtu siç kam deklaruar më parë për automjetin tim të mëparshëm tip ‘Volkswagen Golf 2’, që kam pasur në pronësi. për periudhën 2003 – 2007, se ishte në pronësinë time por nuk është përdorur asnjëherë nga unë por nga vëllai im F. B., ashtu kam deklaruar edhe për automjetin*

<sup>16</sup>Dosja e ILDKPKI-së (Aneksi \*\*\*).

*tip 'Volkswagen Passat', me targa \*\*\*, se është në pronësi të vëllait F. B. dhe është përdorur edhe nga unë me raste. Kam deklaruar vetëm të vërtetën*".

21.10 Trupi gjykues i Komisionit, pasi vlerësoi faktet dhe rrethanat e konkluduara për këtë pasuri, si dhe i vlerësoi ato në raport edhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, krijoi bindjen se ky automjet është pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe se ajo nuk ka sjellë ndonjë provë të re apo argument bindës, pas dërgimit të barrës së provës, për të provuar të kundërtën.

21.11 Ky vlerësim gjen mbështetje edhe në veprimet e mëpasshme (pas deklaratës *Vetting*), ku kjo pasuri vijon të përdoret prej subjektit dhe djalit të saj dhe se vëllai i saj zotëron dhe përdor automjete të tjera. Subjekti rivlerësues ka një pasuri garazh, ndërkohë, që nuk disponon ndonjë automjet tjetër të deklaruar, të blerë prej saj pas deklaratës *Vetting*. Të dhënat nga sistemi Tims janë të vetmit tregues që mund të përdoren nga Komisioni pasi ai nuk mund të verifikoj përdorimin e automjetit brenda vendit apo ku ai parkohet.

21.12 Në përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit për këtë pasuri, duke u ndodhur në kushtet e gërmës "c", të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke e konsideruar këtë automjet si pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**22. Depozitë bankare në shumën 38,899.08 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë e tetë cent) euro, në "Alpha Bank", në emër të znj. Manjola Bejleri dhe në pronësi të znj. Manjola Bejleri 27,439 (njëzet e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) euro dhe E. Xh. 11,460 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) euro.**

22.1 Komisioni ka hetuar lidhur me krijimin e kësaj llogarie (historikun e saj dhe të ardhurat e shërbyera si burim).

22.2 Në datën 29.6.2011 është transferuar shuma prej 790 (shtatëqind e nëntëdhjetë) euro në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në "Raiffeisen Bank" nga shoqëria "\*\*\*\*", si rimbursim për seminarin 7-ditor të kryer në Mynih nga Misioni Euralius. Këto fonde kanë qëndruar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2011 – 2015. Komisioni ka llogaritur si të ardhur shumën 790 (shtatëqind e nëntëdhjetë) euro në qershor të vitit 2012 dhe ka llogaritur si shpenzim udhëtimi dhe trajnimi të njëjtën vlerë të kryer në prill të vitit 2011.

22.3 Gjendje në llogarinë bankare në "Raiffeisen Bank", në shumën 68,705 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesë) lekë (e deklaruar në vitet 2011-2012) të ardhura nga paga. Komisioni nuk konstaton probleme për këtë burim.

22.4 Derdhur *cash* shuma 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë krijuar depozitë me afat 3-mujor, datë 10.7.2012, shtuar + 14,301 (katërmbëdhjetë mijë e treqind e një) lekë (interesa), në "Alpha Bank". Subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të shumës nga shtetasi R. Xh., në deklaratën *Vetting*.

22.4.1 Subjekti ka deklaruar se burimi i shumës prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh është nga shtetasi R. Xh. (ish-bashkëshorti), babai i djalit E. Xh., si detyrim për mirërritjen, ushqimin dhe edukimin e fëmijës, i mbledhur në vite, i papaguar më parë prej tij, dhënë më 8.7.2012, deklaruar me Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.3.2013. Shuma e depozituar është në pronësi të shtetasit E. Xh. dhe në administrim të përbashkët të shtetasve E. dhe Manjola Bejleri (e deklaruar për vitin 2012).

22.4.2 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit shprehet për shumën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, dhënë *cash* nga shtetasi R. Xh., se: "... shpenzimet e kryera nga unë për ushqimin, edukimin dhe mirërritjen e fëmijës kanë qenë më të larta se shuma prej 3.000 lekësh/muaj caktuar me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 21.8.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. R. Xh. (ish-bashkëshorti), babai i djalit tim E. Xh., i ndërgjegjshëm për këtë fakt, vendosi që për ditëlindje t'i japë djalit shumën sa më sipër".

22.4.3 Komisioni verifikoi lidhur me mundësitë financiare të ish-bashkëshortit të subjektit R. Xh. për dhënien e kësaj shumë. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i

rivlerësimit duket se shtetasi R. Xh. ka ushtruar aktivitet tregtar “bar-kafe”, i regjistruar si person fizik prej vitit 1993, por nuk provohet vlera e përfutur e xhiros, fitimit të deklaruar në vite<sup>17</sup> pranë DRT-së Tiranë, si dhe pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore.

22.4.4 Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe lëvizjen e llogarisë në “ProCredit Bank”, nga e cila rezulton se shtetasi R. Xh. ka paguar sigurimet shoqërore si i vetëpunësuar për periudhën 2005 – 2010. Në lëvizjen e llogarisë bankare në “ProCredit Bank” rezulton se janë paguar taksat e bashkisë dhe tarifafat vendore lidhur me aktivitetin e ushtruar bar-kafe, për vitet 2007 – 2010.

22.4.5 Në vijim, Komisioni ka kërkuar informacion të detajuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë dhe sipas shkresës së lëshuar prej saj<sup>18</sup> rezulton se: (a) shtetasi R. Xh. është regjistruar si person fizik në sistemin tatimor në datën 22.2.2003 me aktivitet bar-kafe; (b) ky aktivitet është me status pasiv prej datës 16.12.2014; (c) ka detyrime të pashlyera në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë me përshkrimin “gjobë e regjistruar për tatimin e thjeshtuar për tatimin”.

22.4.6 DRT-ja Tiranë ka përcjellë informacion lidhur edhe me qarkullimin e kryer, ndër vite, nga ky aktivitet tregtar, i paraqitur në mënyrë të detajuar si vijon:

Vitet	Qarkullim	Fitim pas tatimit
2003	1.500.000	0
2004	2.250.000	0
2005	3.500.000	0
2006	4.000.000	0
2007	Në varësi të pushtetit lokal	
2008	2.600.000	1.017.000
2009	2.300.000	436.500
2010	0	0
Total	<b>16.150.000</b>	<b>1.453.500</b>

22.4.7 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Tiranë rezulton se shtetasi R. Xh. ka qarkulluar xhiron tregtare në vlerën 16,150,000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe ka deklaruar fitime pas tatimit në vlerën 1,453,500 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, për vitet 2008 - 2009. Duke marrë në konsideratë fitimin *neto* të deklaruar, për vitet 2008 – 2009, rezulton se ky subjekt tregtar ka realizuar një marzh *neto* fitimi për vitin 2008, në masën 39% dhe një marzh *neto* fitimi për vitin 2009, në masën 19%.

22.4.8 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Tiranë rezulton se personi fizik tregtar “R. Xh.” ka qenë subjekti i pagesës së tatimit të thjeshtuar të fitimit, për vitet 2003 – 2006, në total vlerën 308,269 (treqind e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë (përkatësisht: shumë 60,000 lekë për vitin 2003; shumë 90,000 lekë për vitin 2004; shumë 98,269 lekë për vitin 2005; si dhe shumë 60,000 lekë për vitin 2006), ndërkohë për vitet 2007 dhe 2010 rezulton si subjekt tregtar me qarkullim vjetor më të vogël se vlera 2,000,000 (dy milionë) lekë, nën varësinë e pushtetit lokal. Bazuar në lëvizjen e llogarisë në “ProCredit Bank”, rezulton se ky shtetas ka paguar rregullisht kuotat fikse të taksave të Bashkisë Tiranë për vitin 2007 dhe vitin 2010.

22.4.9 Komisioni ka marrë në konsideratë marzhin e fitimit në nivelin më të ulët të deklaruar në DRT-në Tiranë, në vitin 2008, duke e aplikuar për llogaritjen e fitimit potencial që mund të realizojë ky aktivitet tregtar, në periudhën 2003 – 2006. Në këtë periudhë subjekti tregtar ka qarkulluar xhiron në shumë 11,250,000 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, së cilës duke e aplikuar marzhin prej 19%, rezulton një fitim potencial prej 2,137,500 (dy

<sup>17</sup>Vendim gjykatë nr. \*\*\*, datë 15.7.1993, për regjistrimin si person juridik të shtetasit R. Xh.. Certifikatë Regjistrimi nga Bashkia Tiranë i subjektit tregtar R. Xh. me NIPT \*\*\*, si biznes i vogël me aktivitet “bar-kafe”; ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, lëshuar në datën 24.1.2020, ku rezulton se subjekti tregtar “R. Xh.”, person fizik, është me status aktiv. Vërtetim nga DRT-ja Tiranë datë 27.1.2020, ku vërtetohet se personi fizik “R. Xh.” me aktivitet “bar-kafe” është në status pasiv që në datën 16.12.2014. Librezë kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, nga e cila rezulton se janë derdhur kontributet për periudhën janar – qershor 2005, për vitin 2006, për janar-qershor 2007, për vitin 2008-2009. Lëvizje llogarie nga “ProCredit Bank” për periudhën 2003 – 2012. Bazuar në lëvizjen e llogarisë rezulton se janë paguar taksat vendore për aktivitetin tregtar gjatë periudhës korrik 2007 – dhjetor 2010. Librezë depozite në Bankën e Kursimeve, çelur në datën 10.1.1996, në shumën fillestare 60,000 lekë, e shtuar në vlerën 153,636 lekë në datën 30.1.1997.

<sup>18</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2021.

milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekësh, të cilës po t'i zbritet, më tej, vlera e tatimit të thjeshtuar të paguar në vlerën 308,269 (treqind e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, rezulton një fitim *neto* pas tatimit potencialisht në vlerën 1,829,231 (një milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë.

22.4.10 Në tabelën vijuese është pasqyruar analiza financiare ku përfshihet: (a) fitimi potencial *neto* që mund të realizohet në vitet 2003 – 2009, në vlerën 3,336,731 (tre milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekë (duke marrë në konsideratë edhe fitimin e deklaruar në DRT-në Tiranë); dhe (b) dhurata monetare e deklaruar *cash* në vitin 2012, në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

Vitet	Qarkullimi	Marzhi i fitimit	Tatim i thjeshtuar i fitimit <sup>19</sup>	Fitimi <i>neto</i> pas tatimit
<b>2003 - 2006</b>	11.250.000	19% - sipas Komisionit	308.269	1.829.231
<b>2008</b>	2.600.000	39% - sipas DRT-së Tiranë	113.000	1.017.000
<b>2009</b>	2.300.000	19% - sipas DRT-së	48.500	436.500
<b>Total</b>	16.150.000			3.336.731
<b>2012</b>	Dhuratë monetare <i>cash</i> për djalin			1.500.000
<b>Rezultati</b>				1.836.731

22.4.11 Duket se shtetasi R. Xh. mund të ketë mundësi financiare me të ardhura nga burime të ligjshme, deri në vitin 2009, të krijojë shumën prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, por nuk ekziston ndonjë provë se kjo shumë ka ekzistuar deri në vitin 2012, duke mbetur në nivel deklarativ. Këto të ardhura deri në këtë moment janë llogaritur në analizën financiare të Komisionit.

22.5 **Derdhje e shumës 82,000 (tetëdhjetë e dy mijë) lekë, datë 21.11.2012**, nga znj. Manjola Bejleri, për interesa të djalit E. Xh.. Burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat nga paga. Këto shpenzime janë llogaritur në analizën financiare.

22.6 **Derdhje e shumës 1,103,698.7 (një milion e njëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë e shtatë qindarka) lekë, në datën 21.11.2012, nga shtetasi F. B. (vëllai i subjektit)**. Kjo shumë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se është në pronësi të shtetasit F. B. (e marrë sërish në fund të kontratës). Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume nga vëllai i saj.

22.6.1 Komisioni ka kërkuar<sup>20</sup> nga subjekti i rivlerësimit të shpjegojë lidhur me deklarinimin “*derdhje mbi këtë llogari nga F. B. e shumës 1,103,698.7 (një milion e njëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë e shtatë qindarka) lekë ...*”, qëllimin dhe burimin e të ardhurave.

22.6.2 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se *shuma prej 1,103,699 lekësh e z. F. B. iu bashkua llogarisë së shtetasve Manjola Bejleri dhe E. Xh., vetëm me qëllimin për t'u përdorur, për të përfutur të ardhura nga interesat bankare, me qëllimin e dhurimit të interesave të djalit E. Xh. për studime të larta. Kjo shumë nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të shtetasve Manjola Bejleri dhe E. Xh.. Në përfundim të mbarimit të afatit të depozitës, kjo shumë është tërhequr sërish nga z. F. B. në datën 4.9.2014, kur është bërë tërheqja totale në bankë nga znj. Manjola Bejleri e të gjithë shumës prej 2,950,000 (dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, siç është shpjeguar më sipër. Pra, e thënë në mënyrë të thjeshtë, kjo depozitë në fund u shpërnda siç ishte formuar, me të vetmin ndryshim, që djali E. Xh. përfitoi me dhurim interesat e saj.*

22.6.3 Në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, subjekti i rivlerësimit sqaron se: “*... kjo llogari është hapur në datën 30.5.2011 nga F. B. me shumën 300,000 lekë, me përshkrimin: ‘derdhje nga F. B. për depozitë me afat’. Burimi i krijimit të shumës prej 300.000 lekësh janë të ardhurat e tij nga paga si pedagog pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i*

<sup>19</sup>Shihni shkresën e dërguar nga DRT-ja Tiranë, informacionin e detajuar për vitet 2003 – 2006.

<sup>20</sup>Shihni përgjigjen nr. 5 në pyetësorin datë 18.3.2021.

*Tiranës, Ekspert Trajnimesh, avokat, etj. Në lidhje me dokumentacionin justifikues ligjor të kërkuar nga ju për burimin financiar të shtetasit F. B.. Në dokumentin 'nxjerrje llogarie e F. B. datë 29.1.2020 nga 'Alpha Bank', pasqyrohet më tej se, po në datën 13.5.2011, është kaluar nga bashkëshortja e tij E. B. (Ç.) tek F. B. shuma prej 708,500 lekësh me përshkrimin: 'IPM-transferim mes 2 llog. Alpha Bank). Burimi i krijimit: sqarohet se bashkëshortja E. B. (Ç.) ka punuar në institucionet bankare që prej vitit 2002. Në vitin 2009 ka filluar punë pranë 'Alpha Bank' në poste të larta drejtuese, me pagë mujore mbi 300,000 lekë dhe vazhdon të punojë në të njëjtin institucion”.*

22.6.4 Nga lëvizja e llogarisë në “Alpha Bank” të subjektit të rivlerësimit rezulton se në datën 21.11.2012 asaj i ka kaluar në llogari shuma 1,103,698 (një milion e njëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë me transfertë nga llogaria bankare e shtetasit F. B..

22.6.5 Nga vlerësimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ka kthyer shumën prej 1,103,698 (një milion e njëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh të vëllait, si dhe ka deklaruar, gjithashtu, se e ka marrë këtë shumë për ta përdorur për djalin e saj (studime) dhe pasi nuk e kanë përdorur kanë vendosur ta kthejnë.

22.6.6 Në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, subjekti i rivlerësimit sqaron se: “Në datën 4.9.2014, vëllai im F. B. ka qenë së bashku me mua prezent në ambientet e ‘Alpha Bank’, kur është bërë tërheqja totale e shumës 2,950,000 lekë. Pjesa takuese e vëllait (që përbënte të ardhura të tij dhe të bashkëshortes) u mor prej tij cash, në bankë, në të njëjtin moment që u tërhoq nga arka shuma sa më sipër. Siç e kam shpjeguar, kjo depozitë në fund u shpërnda siç ishte formuar, me të vetmin ndryshim që E. Xh. përfitoi me dhurim interesat e saj”.

22.7 Shuma e krijuar nga burimet e renditura më lart dhe të depozituara në “Alpha Bank”, është tërhequr në shtator të vitit 2014 nga subjekti rivlerësimit, duke u deklaruar në DPV-në e vitit 2014 (plotësuar në mars të vitit 2015), me përshkrimin “tërheqje për blerje banese që nuk u realizua”.

22.7.1 Në datën 31.3.2015, subjekti i rivlerësimit depoziton *cash* shumën 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, në “Raiffeisen Bank”, me përshkrimin “të ardhura të tërhequra nga ‘Credins Bank’ dhe ‘Alpha Bank’”. Shuma e tërhequr nga “Credins Bank” shpjegohet më poshtë (pika 22.8).

22.7.2 Shuma gjendje në llogarinë në euro, në “Raiffeisen Bank”, është konvertuar me transaksion bankar, në datën 28.7.2016, në monedhën dollar, në vlerën 42,400 (dyzet e dy mijë e katërqind) USD. Po në vitin 2016 e tërë shuma është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit në monedhën dollar nga “Raiffeisen Bank” dhe në datën 21.10.2016 është depozituar me këmbim në “Alpha Bank”, në vlerën 38,899 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro.

22.8 **Shuma 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë**, depozituar *cash* në datën 8.5.2013, nga subjekti i rivlerësimit në “Credins Bank”, për çeljen e një depozite kursimi me afat 12-mujor. Kjo shumë është tërhequr në shtator të vitit 2014 nga subjekti rivlerësimit, duke u deklaruar në DPV-në e vitit 2014 (plotësuar në mars të vitit 2015), me përshkrimin “tërheqje për blerje banese që nuk u realizua”. Kjo shumë i është bashkuar shumës së tërhequr nga “Alfa Bankë” në vitin 2014 dhe në vitin 2015 është deklaruar nga subjekti si burim për çeljen e depozitës në “Raiffeisen Bank”, në datën 31.3.2015. Kjo shumë, siç është shpjeguar edhe më lartë, pas disa transaksionesh bankare është depozituar në monedhën euro si pjesë përbërëse e depozitës në “Alpha Bank”, në vlerën 38,899 euro, në vitin 2016.

22.8.1 Subjekti rivlerësimit ka deklaruar se ka përfituar shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë si trashëgimi pas ndarjes nga jeta të babait në datën 18.6.2012, duke deklaruar si burim të ardhur nga puna e tij, kursime,etj.

22.8.2 Në DPV-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, si trashëgimi pas ndarjes nga jeta të babait në datën

18.6.2012. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi çelje depozite në vlerën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë në “Credins Bank” me burim: *“Trashëgimia e përfutur pas vdekjes së babait tim, U. B., në datën 18.6.2012, deklaruar vitin e kaluar”*.

22.8.3 Nga hetimi ka rezultuar se në datën 3.11.2016 është lëshuar Dëshmia e Trashëgimisë Ligjore nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë shtetasit N., A., Manjola dhe F. B., të cilët trashëgojnë nga ¼ pjesë secili.

22.8.4 Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë Deklaratën Noteriale<sup>21</sup> të datës 14.12.2019, të shtetasve N. dhe F. B., të cilët deklarojnë se: *“... trashëgimlënësi ia ka lënë amanet që nëse do ndërronte jetë shuma e mbetur e të ardhurave të tij t’i jepej vajzës së tij Manjola Bejleri si prind i vetëm, si dhe burimi i të ardhurave të tij janë nga puna prej 47 vitesh si gjyqtar e, më pas, avokat dhe kjo shumë është mbajtur prej tij në banesë për nevoja shëndetësore”*.

22.8.5 Komisioni i ka kërkuar<sup>22</sup> subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacion lidhur me përfitimimin e kësaj shume nga shtetasi U. B. dhe burimin e këtyre të ardhurave.

22.8.6 Nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se shtetasi U. B. (babai i subjektit) i ka dhënë hua<sup>23</sup> disa herë shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. në shumën totale prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, në periudhën 1997 – 2000 dhe ka përfutur shumën e interesave prej 2,215,000 (dy milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh, në periudhën 1997 – 2007, dokumentuar me fatura të thjeshta të cilat nuk janë deklaruar pranë organeve tatimore. Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se nuk ka dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve përkatëse tatimore për interesat e përfuturara ndër vite dhe, për këtë arsye, ato nuk mund të merren në konsideratë si burim për krijimin e kësaj pasurie.

22.8.7 Subjekti i rivlerësimit, pasi është pyetur lidhur me pagimin e tatimit për këto të ardhura nga babai i saj, është shprehur se burim për krijimin e shumës së dhuruar kanë qenë të ardhurat e tij, ndër vite, nga puna si: inspektor në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në periudhën 16.3.1998 – 30.6.2006; gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën maj 1980 – janar 1988; gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë për periudhën 1.1.1990 – 28.5.1992; si dhe këshilltar në Kryeministri për periudhën 1994 – 1996.

22.8.8 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur në total të ardhura nga paga/pensione, për periudhën 1990 – 2012, në shumën 11,006,939 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) lekë. Komisioni mban në konsideratë se këto të ardhura në total datojnë që prej vitit 1990 dhe se shuma e deklaruar si e përfutur është në vitin 2012, po ashtu edhe faktin se babai duhet të ketë pasur përveç shpenzimeve për jetesë edhe shpenzime të mundshme shëndetësore, shkollimi për fëmijët apo investime të ndryshme.

22.9 Në përfundim të hetimit:

a) Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë për Komisionin:

- i) marrjen e shumës së pretenduar prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, si dhe mundësitë financiare me burim të ligjshëm të të ardhurave të ish-bashkëshortit;
- ii) marrjen e shumës prej 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekësh, si trashëgimi nga babai i saj dhe mundësitë financiare me burim të ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës;
- iii) burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës në vitin 2011 nga vëllai F. B..

b) Subjekti duhet të provojë se shuma që i përkiste vëllait të saj është kthyer dhe nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo shpenzimi.

c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2014, e cila është deklaruar edhe si burim për krijimin e depozitës në vitin 2015.

<sup>21</sup>Shihni përgjigjen nr. 6 në pyetësin standard datë 11.2.2020.

<sup>22</sup>Shihni përgjigjen nr. 2 në pyetësin datë 6.3.2020.

<sup>23</sup>Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësit standard, dokumentacionin bashkëlidhur (deklaratë noteriale nga shtetasja F. E., kopje të kontratave të huas, mandatpagesat e interesave ndër vite dhe për shlyerjen e principalit në vitin 2007).

22.10 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22.11 Në vijim të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si vijon:

○ **“Lidhur me pikën e parë deklaroi se deri në këtë moment nuk disponoj më dokumentacion tjetër për të provuar lidhur me shumën prej 1,500,000 lekësh mundësitë financiare me burim të ligjshëm të të ardhurave të ish-bashkëshortit. Për më tepër, kjo gjë është hetuar hollësisht nga ju duke u provuar se: ‘Duket se shtetasi R. Xh. mund të ketë mundësi financiare me burime të ligjshme të kursejës shumën prej 1.500.000 lekësh me burim nga aktiviteti tregtar bar - kafe’.**

*Dhënien e kësaj shume djalit tim E. Xh., ish-bashkëshorti R. Xh. e ka deklaruar në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.3.2013, pranë noteres Dh. Q.*

*Mënyrën e dhënies cash të kësaj shume djalit tim E. Xh., ish-bashkëshorti R. Xh. e ka deklaruar në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2021, të R. Xh., me notere Dh. Q.*

○ **Lidhur me pikën e dytë për marrjen si trashëgimi të shumës prej 3,200,000 lekësh nga babai U. B., si dhe mundësitë financiare me burim të ligjshëm të të ardhurave për krijimin e saj, deklaroi se siç konstatohet qartazi vetëm nga dokumentet e paraqitura dhe të analizuara nga ju, ai ka pasur mjaftueshmërisht të ardhura për të kursyer këtë shumë (edhe pse nga ana juaj nuk është marrë në konsideratë shuma prej 1.500.000 lekësh që ai e ka dhënë hua, apo të ardhurat që janë fituar nga prindërit e mi nga shitja e shtëpisë së gjyshit M. D. më 17.9.1991, në shumën 8571.42 USD.**

*Gjithashtu, përveç të ardhurave sa më sipër, ka pasur të ardhura nga paga edhe për dy periudha pune (shkurt 1998 – 31.12.1989 dhe korrik 1992 – 15.8.1994) si gjyqtare, të dhënat e të cilave verbalisht më janë deklaruar se nuk kanë mundur t’i gjejnë në Drejtorinë e Arkivit Qendror pranë ISSH-së Lundër.*

*Ndërsa në lidhje me mënyrën e marrjes së kësaj shume nga unë, përveç Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.12.2019, me notere Dh. Q., të shtetasve N. dhe F. B., të cilën ju e keni, po ju paraqes si provë të re edhe Deklaratën e firmosur në prani të “Justice of The Peace”, datë 8.10.2021, nga A. B..*

*Lidhur me sa është kërkuar nga ju se ‘subjekti duhet të shpjegojë nëse babai i saj ka përfituar njëkohësisht edhe pension edhe pagën si inspektor për periudhën 1998 – 2006’ po të lexohen me kujdes, konstatohet qartë se babai im, U. B., nuk ka përfituar pension dhe pagë njëherësh, por ka përfituar pension ose pagë për periudha të caktuara, total 9,692,450 lekë.*

○ **Lidhur me pikën e tretë për burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës në vitin 2011 nga vëllai F. B., përveç sa kam deklaruar dhe provuar më parë, po citoj Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2021, me notere N. Z. Xh., të dhënë nga vëllai F. B.. Në këtë deklaratë noteriale të lëshuar në vitin 2021 shtetasi F. B. konfirmon deklarinimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit (motra e tij) gjatë pyetësorëve të Komisionit dhe, në përfundim, deklaroi se këtë shumë e ka marrë direkt nga arka cash në datën 4.9.2014, në të njëjtin moment kur motra ime Manjola Bejleri ka tërhequr shumën totale të llogarisë së saj (të bashkuar me llogarinë time) në degën e ‘Alpha Bank’.**

*Me këtë deklaratë të dhënë nga vëllai im provohet edhe kërkesa juaj e bërë në pikën 8.9/2, ku thuhet se ‘subjekti duhet të provojë se shuma që i përkiste vëllait të saj është kthyer dhe nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo shpenzimi’.*

*Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitës sa më sipër, provohet qartazi se vëllai F. B., në atë kohë, ka pasur mjaftueshmërisht të ardhura të ligjshme për të provuar burimin e krijimit të shumës së tij prej 300,000 lekësh.*

*Ndërsa për shumën 708,500 lekë, të depozituar nga bashkëshortja e tij E. B. (Ç.), përveç provave që kam paraqitur më parë (statement i llogarive bankare ku pasqyrohen të gjitha lëvizjet e përshkruara më sipër), lidhur me burimin e krijimit po paraqes edhe tri prova të reja:*

vërtetim, datë 5.10.2021, i 'Alpha Bank', ku provohet se llogaria (pagë) në emër të znj. E. B. (Ç.) është hapur që në vitin 2009 dhe se shuma prej 708,500 lekësh e krijuar nga kursimet e saj nga paga, ka kaluar në llogarinë e z. F. B. në datën 13.5.2011; nxjerrje llogarie datë 13.5.2021 e 'Alpha Bank', ku provohet se në llogarinë e z. F. B. ka kaluar në datën 13.5.2011 shuma prej 708,500 lekësh nga llogaria e znj. E. B.; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2021 i 'Alpha Bank', me të cilin provohet se znj. E. B. (Ç.) është punonjëse e bankës që nga data 14.10.2009 dhe, aktualisht, ka pozicionin e drejtoreshës së Departamentit të Shitjeve dhe Produkteve Bankare me Pakicë, me të ardhura vjetore bruto prej 4,225,000 lekësh (neto 3,687,454 lekë)".

o Lidhur me pikën 22.9 (b) dhe (c), subjekti ka shpjeguar sa vijon: "Fakti që shumën prej 36,000 euro e kam mbajtur cash provohet me faktin që nuk e kam deklaruar të shpenzuar, ashtu siç kam bërë me shumën prej 2,600 euro.

Konstatimi juaj se unë nuk kam deklaruar gjendje cash, apo ndryshime të gjendjes cash në vitin 2014 lidhur me këto shuma, nuk është i vërtetë apo i saktë.

Gjendjen cash e kam deklaruar në DPV-në e vitit 2014 me termin 'tërheqje', pasi këtë veprim e kam kryer faktikisht në bankë, 'tërheqje cash' të këtyre të hollave, siç edhe provohet me mandatin bankar. Unë e kam deklaruar veprimin me atë term ashtu siç e kam kryer realisht, sipas definicionit bankar të transaksionit "tërheqje", i cili do të thotë gjithmonë "tërheqje cash". Vlerësoj se jam e qartë në deklarin tim, se kjo shumë ishte "tërhequr cash" dhe mbahej cash tek unë deri më 31.12.2014, sipas kërkesës së plotësimit të formularit të deklarinimit periodik. Kuptohet qartë se të gjitha shumat e tërhequra nga bankat dhe që përbëjnë shumën 36,000 euro nuk janë shpenzuar nga unë, pasi në të kundërt do të ishin deklaruar te faqja e formularit për 'Shpenzimet e Deklarueshme', ashtu siç kam deklaruar shpenzimin e shumës që përbën 2,600 euro.

Theksoj, se deklarimi im është kryer në përputhje të plotë dhe në zbatim të kërkesave të formularit të DPV-së së vitit 2014 në faqen me titull 'Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit'.

Deklarimi im ka pasqyruar pikërisht veprimin e kryer, vlerën dhe gjendjen cash të shumave të tërhequra në bankë sa më sipër, të cilat janë të tilla pa asnjë ndryshim, deri më 31.12.2014. Vërej se deklarimi im është kryer në përputhje të plotë me ligjin dhe me formën e miratuar sipas 'Udhëzues mbi plotësimin e dokumentit zyrtar deklarativ e interesave private', të publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI-së dhe, si rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me mosdeklarim të gjendjes cash në fund të vitit 2014".

22.12 Në vijim, trupi gjykues vlerëson se shuma prej 38,899.08 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë e tetë qindarka) euro, e deklaruar në deklaratën Vetting si depozitë bankare në "Alpha Bank", në emër të znj. Manjola Bejleri, në pronësi të znj. Manjola Bejleri në vlerën 27,439 (njëzet e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) euro dhe djali E. Xh. në vlerën 11,460 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) euro ka problematika, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Analiza e kësaj depozite zë një peshë të madhe, pasi është përdorur në vijim për krijimin e një pasurie nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2018, prenotimi i së cilës mund të ketë filluar edhe më herët në vitin 2014, kur subjekti ka deklaruar se ka tërhequr shuma në llogaritë bankare për blerje pasurie. Mosprovimi nga subjekti i deklarimeve të bëra prej saj, lidhur me ndonjë përpjekje të pasuksesshme për krijimin/blerjen e ndonjë pasurie atë vit, mosdeklarimi prej saj i shumës së pretenduar si gjendje cash në banesë, pasi tërheqja është kryer në shtator të vitit 2014 dhe nuk mund të pasqyrojë gjendjen më 31.12.2014, krijuan bindjen se subjekti ka pasaktësi në deklarime, të cilat nuk vijnë në harmoni me deklaratën Vetting dhe ngrenë dyshime të arsyeshme për Komisionin. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se shuma e derdhur në bankë në vitin 2015 është e njëjtë me atë të tërhequr në vitin 2014 për blerje banese, për të cilën Komisioni ngre dyshime se realisht mund të jetë përdorur për krijimin e një pasurie që ka vijuar në vitet 2018 – 2019, duke mbajtur në konsideratë edhe vlerat e këtyre pasurive. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave



për shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, e cila e ka zanafillën në vitin 2012 dhe që pas disa transaksionesh është bërë pjesë përbërëse e shumës 38,899.08 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë e tetë qindarka) euro, e deklaruar në deklaratën *Vetting* si depozitë bankare në “Alpha Bank” e trajtuar në mënyrë të detajuar më poshtë.

22.13 Trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar në përfundim të analizës lidhur me prejardhjen dhe burimin e krijimit të shumës prej 38,899.08 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro, e deklaruar në deklaratën *Vetting*, se nuk justifikohet plotësisht prej subjektit të rivlerësimit, pasi ajo nuk përmbush kërkesat e nenit D pika 3 të aneksit të Kushtetutës.

22.13.1 Për shumën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë me prejardhje nga të ardhurat e ish-bashkëshortit, qëndrimi i trupit gjykues është se nga analiza e bërë ka rezultuar se ai ka pasur të ardhura të ligjshme deri në vitin 2010, në shumën 1,490,000 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, por nuk mund të kryhet një analizë e mirëfilltë lidhur me përdorimin e tyre dhe mbi të gjitha mbi ekzistencën reale të tyre në vitin 2012, kur edhe janë derdhur *cash* në bankë nga subjekti i rivlerësimit. Të ardhurat e trajtuara nga Komisioni janë nga një biznes “bar-kafe”, për të cilin, gjithashtu, nuk dihet nëse ka pasur investime apo riinvestime dhe shpenzime nga shtetasi R. Xh. dhe nëse të ardhurat e dhuruara në vitin 2012 janë pikërisht ky burim. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se nga një llogari hipotetike, ish-bashkëshorti rezulton se ka gjeneruar, ndër vite, të ardhura të ligjshme në një shumë të përafërt me atë të dhuruar prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh në vitin 2012 (pa përfshirë në këtë shumë pagesa të tjera të kryera nga ish-bashkëshorti për kujdes ushqimor dhe tarifë shkollimi ndër vite). Po ashtu, ka ekzistuar edhe një dokument i kohës (Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.3.2013, ndërkohë DPV-ja e vitit 2012 është dorëzuar në datën 1.4.2013, që ka dokumentuar vullnetin e dhuruesit. Ndodhur përpara këtyre fakteve dhe provave është krijuar bindja se këto të ardhura duhet të merren në konsideratë në analizën financiare.

22.13.2 Për shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, me burim trashëgimi nga babai në vitin 2012 dhe të padeklaruar si gjendje *cash* në banesë në këtë vit, derdhur në bankë në vitin 2013, trupi gjykues nuk është bindur për të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk ka rezultuar e provuar me ndonjë dokument të kohës se kjo shumë ka ekzistuar realisht dhe nëse ka ekzistuar i është dhuruar përjashtimisht subjektit të rivlerësimit (një nga katër trashëgimtarët e të ndjerit). Po ashtu, edhe çelja e trashëgimisë në vitin 2016 apo dokumente të tjera nuk flasin për ekzistencën e kësaj shume në vetvete dhe as për përfitimin e saj të menjëhershëm nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri. Deklaratat noteriale të lëshuara nga familjarët (trashëgimtarët e tjerë) gjatë periudhës së rivlerësimit nuk përbëjnë ndonjë vlerë provuese të ekzistencës së këtyre lekëve në vitin 2012, si dhe nuk ekziston as ndonjë gjurmë e mëparshme mbi ekzistencën e një shume të tillë si depozitë apo gjendje llogarie. Mundësia hipotetike e z. U. B. për të pasur të ardhura, ndër vite, në vlerat e dokumentuara nuk u vlerësua si e mjaftueshme për trupin gjykues për të pranuar faktin se shuma ishte kursyer dhe se ajo ekzistonte në vitin 2012. Dokumenti i vetëm i kohës është deklarimi periodik vjetor, i bërë nga subjekti i rivlerësimit, i cili nuk u vlerësua nga trupi gjykues si i mjaftueshëm për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi ekzistencën e shumës së deklaruar nga subjekti prej 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekësh, me prejardhje nga trashëgimia, pasi ai mbetet në nivel deklarativ nga subjekti i interesuar. Në vijim të fakteve, shuma 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, u vlerësua nga trupi gjykues se nuk duhet të merret në konsideratë si burim të ardhurash në vitin 2013 në krijimin e depozitës në “Credins Bank” dhe, për pasojë, as në krijimin e depozitës në “Alpha Bank” në vitin 2015, përtej problematikave të tjera lidhur me këtë depozitë.

22.13.3 Për shumën 1,103,698.7 (një milion e njëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë e shtatë qindarka) lekë, si derdhje nga z. F. B. më 21.11.2012, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pronësi të të vëllait (e marrë sërish në fund të kontratës), trupi gjykues nuk u bind nga shpjegimet e dhëna prej subjektit se ishte dhënë me qëllim për të përfituar djali i saj disa interesa nga mbajtja e tyre në depozitë pasi, së pari, burimi i deklaruar gjatë rezultateve të hetimit rezulton me prejardhje (pjesa më e madhe) edhe nga të ardhurat e bashkëshortes së vëllait dhe se nuk ka një logjikë të arsyeshme se ajo ia jep djalit të subjektit të rivlerësimit që

të përfitojë interesa. Së dyti, kthimi i saj mbetet i paprovuar me ndonjë gjurmë dhe sipas deklarimeve periodike është bërë *cash*, por nuk provohet në ndonjë mënyrë se ato të ardhura nuk janë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie që ka vijuar në të ardhmen.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e subjektit nuk kanë provuar në mënyrë të qartë dhe bindëse për trupin gjykues shkaqet e këtij veprimi, por në fund ato nuk kanë rezultuar të jenë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti apo personi tjetër i lidhur me të dhe, sipas deklarimeve të saj, janë kthyer. Trupi gjykues ka vlerësuar se faktet e konstatuara nuk mund t'i atribuohen ndonjë shkeljeje ligjore të tillë që të jetë e mundur të identifikohet si një shkak që të mund të ngrihet në nivelin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit në përputhje me ndonjë nga parashikimet e pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

22.14 Në përfundim, trupi gjykues ka vlerësuar se burimi i shumës prej 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekësh nuk duhet të merret në konsideratë si një burim i ligjshëm për krijimin e depozitës, fillimisht, në vitin 2013, për të gjitha shkaqet e paraqitura më lart, duke krijuar kështu një situatë negative financiare në vlerën -3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë. Po ashtu, trupi gjykues ka vlerësuar të mos e konsiderojë shumën prej 5.386.850 lekë e deklaruar si tërheqje *cash* dhe e konvertuar në euro nga subjekti i rivlerësimit) si gjendje *cash* në fund të vitit 2014 dhe, për pasojë, as si burim shumën prej 35,000<sup>24</sup> (tridhjetë e pesë mijë) euro për krijimin e depozitës prej 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro në vitin 2015 në “Raiffeisen Bank”, si për shkak të deklarimeve, po ashtu edhe për shkak të burimit të krijimit të një pjesë të saj (prejardhjes).

22.15 Lidhur me mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit të këmbimit të shumave nga lekë në euro në vitin 2014, Komisioni ka pasur në vëmendje deklaratime të mundshme nga DPP-ja për konvertim të shumave nga lekë në euro (nisur nga vlera e lartë e tyre), por gjithsesi pranon faktin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit se ato mund të jenë kryer në mënyra të tjera sipas shpjegimeve të dhëna prej saj. Trupi gjykues gjen të pambështetur shpjegimin e dhënë nga subjekti se ka tërhequr këto shuma në vitin 2014, vetëm për t'i konvertuar në monedhën euro dhe se i ka mbajtur në banesë për një periudhë rreth 6-mujore, pa pasur ndonjë projekt konkret dhe vetëm për dëshirën e saj për të blerë një pasuri, apartament, e cila sipas verifikimeve nga Komisioni ka rezultuar se është konkretizuar në vitin 2018 dhe se mund ta ketë zanafillën rreth vitit 2015. Megjithatë trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të provojë një situatë pasive (që nuk ka ndodhur), ajo duhet të provonte së paku që deklaratimet e saj për blerjen e një pasurie që nuk u realizua, nuk kanë prodhuar marrëdhënie konkrete. Deklarimet e saj gjatë shpjegimeve se ajo i tërhoqi për të parë mundësinë dhe i konvertoi thjesht sepse pasuritë bliheshin në euro, nuk u vlerësua si një argument bindës për trupin gjykues.

22.16 Në përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se faktet e konstatuara identifikohen si një shkak që ngrihet në nivelin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**23. Depozitim *cash* në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në datën 2.6.2008, në shumat 300,000 (treqind mijë) lekë, 9,000 (nëntë mijë) euro dhe 2,500 (dy mijë e pesëqind) USD, pra, në total shumën 1,636,043 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e tre) lekë dhe tërhequr *cash* në datën 4.7.2008, përkatësisht shumat 300,000 (treqind mijë) lekë, 9,000 (nëntë mijë) euro dhe 2,500 (dy mijë e pesëqind) USD.**

23.1 Nga hetimi i lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 2.6.2008 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 300,000 (treqind mijë) lekë në llogarinë e pagës në lekë, shumën 9,000 (nëntë mijë) euro në llogarinë rrjedhëse në euro dhe shumën 2,500 (dy mijë e pesëqind) USD në llogarinë e çelur përkatësisht atë ditë në monedhën dollar.

23.2 Nga hetimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, rezulton se në datën 4.7.2008 subjekti i ka tërhequr *cash* këto shuma respektive nga llogaritë bankare, përkatësisht 300,000 (treqind mijë) lekë, 9,000 (nëntë mijë) euro dhe 2,500 (dy mijë e pesëqind) USD.

<sup>24</sup>Shumë që rrjedh nga konvertimi i vlerës 5.386.850 lekë (sipas deklarimeve të subjektit).

Komisioni, shumën totale prej 1,636,043 lekësh (ekuivalent i shumave të mësipërme), e ka llogaritur si shpenzim në analizën financiare të vitit 2008.

23.3 Komisioni ka kryer analizën financiare deri në datën 2.6.2008, nga e cila duket se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare me burime të ligjshme në vlerën 1,475,805 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesë) lekë për të krijuar këtë likuiditet.

23.4 Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për krijimin e shumës totale prej 1,636,043 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e tre) lekësh, të derdhur *cash* në “Raiffeisen Bank”, në monedhat lekë/euro/dollar, në datën 2.6.2008, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Deri në këtë moment ato janë konsideruar vetëm si shpenzime në analizën financiare të Komisionit.

23.5 Në prapësimet e saj, subjekti është shprehur se: *“Shumat e mësipërme, sqaroj se nuk duhen konsideruar aspak si shpenzim, pasi nuk janë shpenzuar. Këto të holla janë përdorur me të vetmin qëllim, për të plotësuar një dokument të ardhurash për të përfituar dhënien e vizës australiane për mua dhe djalin tim E. Xh.. Sqaroj se unë kam aplikuar së bashku me djalin tim E. Xh. për vizë australiane në muajin qershor të vitit 2008, me qëllim për të vizituar vëllain tim A. B. dhe familjen e tij me banim në \*\*\*, Australi. Siç dihet dhe provohet nga faqja zyrtare e imigrimit <https://immi.homeaffairs.gov.au/> i publikuar nga qeveria australiane, një nga dokumentet që kërkohet për dhënien e vizës australiane me afat qëndrimi 3-mujor është vërtetimi bankar lidhur me një depozitë të mjaftueshme të hollash, që duhet të mbulojë shpenzimet e qëndrimit dhe shpenzimet shëndetësore të mundshme etj. për këtë periudhë.*

*Sqaroj se këto të holla, të cilat i kam marrë në atë kohë nga babai im U. B. (i cili i posedonte po *cash* në banesën e tij) i kam derdhur me të vetmin qëllim për t’u pajisur me vërtetimin përkatës nga banka që kërkohet për marrjen e vizës australiane për mua dhe djalin tim.*

*Vizat na janë miratuar në datën 24.6.2008 nga Ambasada Australiane, e cila në atë kohë e kishte zyrën konsullore për Shqipërinë në Athinë, Greqi. Ky fakt provohet nga pasqyrimi i kësaj date në vizat që na janë dhënë. Pasi na u miratuan vizat dhe në kushtet kur të gjitha shpenzimet e qëndrimit tonë në Australi ishin marrë përsipër me deklaratë në ambasadë nga vëllai A. B., pak ditë më pas në datën 4.7.2008 kam tërhequr *cash* nga banka të tria shumat e depozituara më sipër dhe ia kam kthyer sërish babait tim U. B.”.*

23.6 Trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit dhe konstaton se dhënia hua e kësaj shume nga babai i saj apo marrja hua dhe qëllimi i përdorimit të saj, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit asnjëherë më parë gjatë deklaratave periodike vjetore, por as gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar ato as në pyetësonin standard të Komisionit, megjithëse ka deklaruar udhëtimin e saj në Australi. Trupi gjykues nuk gjeti asnjë provë apo fakt që mund të provonte ekzistencën e shumës së derdhur në bankë, nga babai i saj shtetasi U. B. dhe as dhënien e kësaj shume prej tij. Trupi gjykues krijoi bindjen se kjo shumë mbetet e pajustificuar dhe se subjekti i rivlerësimit në vijim mund ta ketë përdorur gjatë udhëtimit 34-ditor në Australi, së bashku me djalin. Këto burime deklarohen nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe krijojnë bindjen që përbëjnë një përpjekje të saj për të shtuar burime të reja krijimi të pasurive gjatë procesit, në funksion të përmbysjes së një analize financiare negative.

23.7 Trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke mos deklaruar këtë burim, për të cilin rezulton në pamundësi financiare me të ardhura të ligjshme.

24. Nga verifikimi i dokumentit “regjistri noterial” kanë rezultuar disa pasuri të krijuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe persona të tjerë të lidhur me të, vëllai F. B., të realizuara pas periudhës së rivlerësimit, të cilat nuk u vlerësuan nga trupi gjykues në procesin e rivlerësimit të subjektit Manjola Bejleri.

**25. Pasuria apartament me sip. 131.16 m<sup>2</sup> dhe 25.27 m<sup>2</sup> sipërfaqe të përbashkëta, me vlerë 184,936** (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) euro, sipas Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2018 dhe shtojcës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.2.2019, me vendndodhje në kompleksin “\*\*\*”, në “\*\*\*”, Tiranë. Pjesa takuese: 100%.

25.1 Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur edhe një Kontratë Sipërmarrjeje në datën 4.10.2019 me shoqërinë “\*\*\*” (S.E.R.E) për blerjen e një vendparkimi, në vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

25.2 Burim për krijimin e pasurisë, të deklaruar nga subjekti, janë përkatësisht: (a) vlera 40,000 (dyzet mijë) euro me burim depozitën prej 38,889 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) euro të deklaruar në deklaratën Vetting; (b) vlera 100,000 (njëqind mijë) euro kredi në Alfa Bankë marr në vitin 2019; (c) vlera 40,000 (dyzet mijë) euro marrë hua pa interes, pa afat, shtetases G.D. në vitin 2019. Subjekti ka marrë edhe një hua në shumën 991,962 (nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, nënës së saj, pa afat dhe pa interes, për të kryer pagesa për shpenzime të ndryshme për apartamentin e banimit në “\*\*\*”. Për pasurinë garazh pagesa do të kryhej në vijim.

25.3 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se është krijuar pas deklaratës Vetting, prandaj, mbështetur edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk e ka përfshirë në rivlerësimin e subjektit Manjola Bejleri.

## **26. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

26.1 Komisioni, bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016.

26.2 Për vitet 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, 2012, 2013, 2014 dhe 2016 duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerje/krijim pasurish, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruar dhe të evidentuara në këto vite (përkatësisht -1.528.029 lekë; -254.995 lekë; -456.351 lekë; -629.796 lekë; -1,482,421 lekë; -3.325.045 lekë; -98.651 lekë; -33.155 lekë dhe -397.969 lekë).

26.3 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kaluar barra e provës për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26.4 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti së bashku me prapësimet shpjegimet mbi analizën financiare të Komisionit, duke kërkuar rishikimin e saj, si dhe marrjen në konsideratë të disa të ardhurave dhe shpenzimeve të llogaritura jo në mënyrë të drejtë dhe konkretisht, subjekti kërkoi:

26.5 Rishikim të disa shpenzimeve që, sipas subjektit, janë llogaritur edhe si zëra brenda paketës “shpenzimet e jetesës sipas INSTAT-it”, edhe veçmas, duke bërë kështu që këto zëra të përlllogariten dyfish duke shtuar fiktivisht shpenzimin përkatës. Këto zëra që përmbajnë shpenzime të dubluara janë: shpenzime me kartë (debiti/Visa Card); shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS; shpenzime për djalin (arsim + shëndet); dhe shpenzime për mobilim.

Subjekti ka kërkuar që për sa kohë këto shpenzime jetese janë të provuara me prova shkresore, nuk ka përse të merren për bazë në mënyrë të dubluar edhe shpenzimet e referencës sipas INSTAT-it.

26.6 Në vijim të kërkesës së subjektit, Komisioni ka vlerësuar se shpenzimet për mobilim, të deklaruar prej saj, në total në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë (të cilat konsistojnë në një dhomë gjumi, bufe kuzhinë, kënd ndenjeje, tavolinë ngrënie dhe pajisje elektrike si frigorifer, televizor, sobë gatimi, lavastovilje, lavatrice, kondicioner, bolier etj.) janë shpenzime të kryera për mobilimin fillestar të një apartamenti të ri në një nga zonat më të shtrenjta të Tiranës,

ndërkohë shpenzimet e INSTAT-it janë shpenzime jetike që çdo shtetas duhet të harxhojë minimalisht për mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës.

26.7 Shpenzimet për djalin – arsim dhe shëndet, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, lidhen me tarifat e paguara për arsimimin në sistemin arsimor privat dhe tarifat universitare, si dhe shpenzimet e shëndetit lidhen me shërbime shëndetësore të marra në sistemin spitalor privat, ndërkohë që shpenzimet e referencës në INSTAT janë shpenzime jetike, lidhur me shërbimin arsimor dhe shëndetësor që çdo shtetas shqiptar duhet të marrë, pa përfshirë ato specifike e të veçanta.

26.8 Lidhur me udhëtimet sipas të dhënave në sistemin *TIMS* janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit duke sistemuar shpenzimet e udhëtimeve për trajnime, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues, janë sistemuar shpenzimet e qëndrimit për djalin gjatë periudhës që ka qenë i mitur, si dhe janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit drejt Italisë për linjat direkte *low cost*.

Lidhur me shpenzime të tjera të udhëtimeve të kërkuara për t'u rishikuar nga subjekti si uljen e shpenzimeve të udhëtimit në Stamboll gjatë vitit 2005, pasi janë mbuluar nga babai duke paraqitur si provë Deklaratën Noteriale të vitit 2021, trupi gjykues ka vlerësuar se mbeten të paprovuara dhe në nivel deklarativ, ato kanë vlerë të kufizuar në provueshmërinë e vlerës reale të shpenzimeve të kryera, pasi rezulton si përpjekje për të justifikuar shpenzimet në funksion të barrës së provës. Trupi gjykues mban në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka kryer udhëtime të shpeshta për turizëm jashtë Shqipërisë në vende të ndryshme si Dubai, Egjipt, Turqi, Spanjë, Portugali, Austri, Australi, Vienë, Francë, Zvicër, Itali, Greqi/Mikonos, Tailandë, Antigua Barbuda etj., duke treguar se ka rritur vazhdimisht cilësinë e jetesës.

26.9 Lidhur me shpenzimet me kartë (debiti/*Visa Card*), të llogaritura nga Komisioni janë përjashtuar shpenzimet e kryera për blerje ushqimore dhe pagesa utilitetesh, në vijim trupi gjykues ka vlerësuar se shpenzimet e tjera janë shpenzime *extra* të kryera nga subjekti i rivlerësimit në përshatje edhe me standardin e saj të jetesës mbi nivelin minimal.

26.10 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për llogaritjen dyfish të shpenzimeve janë reflektuar pjesërisht, kjo duke konsideruar cilësinë e jetesës së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, udhëtimet turistike në vende luksi, krijimin dhe shtimin e pasurive, vlerësohen se janë rrethana që tregojnë se subjekti ka jetuar normalisht duke kapërcyer nivelin e minimumit të shpenzimeve dhe se ato jetike të parashikuara sipas INSTAT-it nuk mund të reduktohen.

26.11 Subjekti ka kërkuar të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme: (a) hua në vitin 2002, në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, nga vëllai A.B., (b) hua në shumën 1,000,000 (një milion) lekë nga vëllai F. B. në shkurt të vitit 2007; (c) shuma 1,000,000 (një milion) lekë nga shitja e banesës në nëntor të vitit 2007; (ç) shuma 1,636,043 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e tre) lekë në vitin 2008, derdhur në bankë dhe tërhequr më pas; (d) shuma 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë nga babai si trashëgimi në vitin 2012; (dh) të ardhurat nga INFOCIP, të përfituara në vitet 2013 dhe 2016, përkatësisht në vlerat 1,620 (një mijë e gjashtëqind e njëzet) USD dhe 1,700 (një mijë e shtatëqind) USD, si dhe disa ndryshime lidhur me konvertimin e monedhave duke u marrë në konsideratë kursi brenda vitit dhe jo kursi mesatar vjetor.

26.12 Po ashtu, subjekti ka kërkuar të merret në konsideratë gjendja *cash* e shumës 35,000 (tridhjetë e pesë) euro në vitin 2014 dhe e përdorur si burim për krijimin e depozitës në vitin 2015.

26.13 Në vijim të kërkesës së subjektit, trupi gjykues çmon se: (a) huaja në vitin 2002 në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, nga vëllai A.B. nuk plotëson kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare; (b) huaja në shumën 1,000,000 (një milion) lekë nga vëllai F. B., në shkurt të vitit 2007, nuk plotëson kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare; (c) shuma 1,000,000 (një milion) lekë e ardhur nga shitja e

banesës në nëntor të vitit 2007, shërbyer si burim për mbylljen e kredisë në shkurt të po këtij viti, nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare pasi shlyerja e kredisë është kryer 10 muaj para se të lidhej kontrata e shitblerjes, si dhe vlera e pretenduar nga subjekti nuk përputhet me situatën reale të pronësisë dhe pjesës takuese të secilit; (ç) shuma prej 1,636,043 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e tre) lekësh, depozituar *cash* në bankë në vitin 2008 nuk plotëson kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare; (d) shuma 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë deklaruar si e ardhur nga babai si trashëgimi në vitin 2012, nuk plotëson kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare si e ardhur në krijimin e depozitës në vitin 2013; (dh) të ardhurat nga INFOCIP janë vlerësuar se plotësojnë kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës duke u përfshirë në analizën financiare.

26.14 Lidhur me kërkesën për konvertimin e monedhave, duke u marrë në konsideratë kursi brenda vitit dhe jo kursi mesatar, trupi gjykues ka vlerësuar se analiza e depozituar nga subjekti i rivlerësimit ka marrë në referencë kursin mesatar vjetor të referuar nga Komisioni.

26.15 Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, që të merret në konsideratë gjendja *cash* e shumës 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro në vitin 2014 dhe e përdorur si burim për krijimin e depozitës në vitin 2015, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, por mbeten në nivel deklarativ gjatë hetimit administrativ dhe nuk reflektohen në gjendjen *cash* në banesë në DPV-në e vitit 2014. Po ashtu, subjekti nuk arriti të bindë Komisionin se kjo shumë nuk ishte përdorur në vitin 2014 për krijimin e ndonjë pasurie tjetër. Edhe sikur të pranohen shpjegimet e subjektit për gjendjen *cash* në banesë në vitin 2015, të shumës prej 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, të përfituar nga konvertimi i shumës në lekë që dispononte si rezultat i tërheqjes nga llogaritë bankare, përsëri kjo situatë krijon pamundësi financiare me burime të ligjshme, pasi rezulton e krijuar nga të ardhurat nga depozita e krijuar në vitin 2013 në “Credins Bank” me burim të ardhurat në shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë nga trashëgimia e babait, e cila nuk është marrë në konsideratë e pranuar nga trupi gjykues, duke mos u pranuar si një burim i ligjshëm. Në vijim të fakteve sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit vlerësoi që të mos konsiderojë shumën 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro si burim të depozitës së krijuar në vitin 2015 me të ardhura të ligjshme sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

26.16 Subjekti ka kërkuar pasqyrimin në analizë të balancave në fund të vitit për dy llogari në monedhën dollar në “Raiffeisen Bank” dhe në “Alpha Bank”, të cilat Komisioni i ka reflektuar në analizën finale financiare.

26.17 Subjekti i rivlerësimit ka rishikuar duke sistemuar analizën financiare, të paraqitur prej saj, duke përfshirë të gjitha të ardhurat e deklaruara prej saj dhe duke rezultuar në vijim në një situatë financiare negative totale në vlerën 1,197,21 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëzet e një) lekë, përkatësisht për vitet 2003, 2005, 2006, 2011, 2012 dhe 2014. Në vijim, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që shumat/tepricat për vitet me rezultat pozitiv të mbarten në vitet pasardhëse.

26.18 Në vijim të kërkesës së subjektit, trupi gjykues çmon se pretendimi i saj nuk qëndron, pasi nuk është i mbështetur në ndonjë bazë ligjore apo praktikë të mëparshme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe se një qëndrim i tillë bie në kundërshtim edhe me metodologjinë e plotësimit të deklarimeve periodike vjetore, ku tepricat/pakësimet jashtë sistemit bankar deklarohen si ndryshime të gjendjes *cash* në banesë dhe që në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk kanë rezultuar deklarime të ndryshimit të gjendjes *cash*, ndër vite, në DPV-të përkatëse. Në këtë vlerësim Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se analiza financiare e kryer për shkak të procesit të rivlerësimit është hipotetike dhe se ajo nuk mbështetet në situata reale, ndaj në mungesë të deklarimeve nga vetë subjektet mbi gjendje *cash* të disponuara në fund të çdo viti, kjo kërkesë nuk mund të pranohet.

26.19 Në vijim, bazuar në faktet dhe argumentet më sipër, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për periudhën 2003 –

2016, në vlerën -13,037,523 (trembëdhjetë milionë e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë duke përfshirë këtu edhe balancën negative të rezultuar nga moslogaritja e gjendjes *cash* në vitin 2014, të shumës prej 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro e reflektuar si balancë negative në vitin 2015 në krijimin e depozitës bankare si mungesë e burimeve të ligjshme. Edhe nëse do të të merrej në konsideratë dhe do të pranohej ekzistenca e gjendjes *cash* në banesë, në vitin 2014, përtej dyshimeve dhe bindjes së brendshme të anëtarëve mbi zanafillën e krijimit të ndonjë pasurie, pikërisht në vitin 2014, përsëri gjendja *cash* e shumës 5,386,850 (pesë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë, e konvertuar në shumën 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, në vitin 2014, do të rezultonte në pamjaftueshmëri për shkak të burimit të krijimit të saj më herët me të ardhurat nga trashëgimia e babait në shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.

26.20 Në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues mbajti në konsideratë se subjekti ka krijuar pasuri dhe ka realizuar shpenzime me të ardhura që janë disa herë më shumë se ato të përfituara prej saj, ndër vite. Subjekti ka përdorur të ardhura të familjarëve të saj apo të të afërmeve të tjerë, për të cilat krijohet bindja se deklaratimet janë fiktive dhe vetëm për të justifikuar burimin e këtyre pasurive.

26.21 Përfundimet e arritura nga trupi gjykues, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, u vlerësuan të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë gjatë periudhës së deklaratës *Vetting* dhe se çdo përfundim tjetër lidhur me pasuri të subjektit, të krijuara pas deklaratës *Vetting*, por që ndërlidhen me burime të ardhurash gjatë periudhës së rivlerësimit apo pasuri dhe detyrime të tjera të saj dhe personave të lidhur, nuk do të mund ta çonte në një vlerësim të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

27. Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar, sipas këshillimit të Njësisë së Shërbimit Ligjor, është negativ dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera ndër vite. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë trupin gjykues lidhur me një sërë transaksionesh financiare të kryera prej saj, i cili në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë arriti në konkluzionin se subjekti nuk ka një nivel të besueshëm dhe se ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm sipas kërkesave të germave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **B. KONTROLLI I FIGURËS**

28. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Manjola Bejleri*. Ky raport është i deklasifikuar.

29. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

30. Është kërkuar përditësim informacioni, por nuk kanë rezultuar të dhëna për këtë subjekt rivlerësimi. DSIK-ja, në përfundim të verifikimeve, ka përcjellë raportin e deklasifikuar plotësisht për subjektin Manjola Bejleri, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës (i përditësuar).

31. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzione për rubrikën e kontrollit të figurës**

32. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nga hetimet nuk rezultuan të dhëna për subjektin e rivlerësimit, për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

33. Raporti i vlerësimit profesional është përgatitur bazuar në raportin e sjellë nga KLGJ-ja, e nga denoncimet e paraqitura në Komisionin nga publiku. Nga ky vlerësim ka rezultuar sa më poshtë vijon.

34. Gjyqtarja Manjola Bejleri ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës më 15.7.1995 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2000. Fillimin në detyrë e ka me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.9.1999, të KLD-së, kur është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin nr. \*\*\*, datë 27.9.2000, të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.11.2001, të KLD-së është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht.

35. Nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, tri u vunë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dy nga Gjykata e Lartë, deri më 24.2.2020. Kopjet e këtyre pesë dosjeve në formatin letër janë përfshirë në dosjen e vlerësimit të subjektit Manjola Bejleri. Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre pesë dosjeve përshkruhen në vijim.

35.1 Dosja 1 – çështja civile me nr. \*\*\* regj., datë 10.2.2014, që i përket paditësit F. Ll., kundër të paditurve shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. dhe Enti Rregullator i Energjisë, me objekt “anulimi i titujve ekzekutivë, faturave të ‘\*\*\*\*’ sh.a. me nr ... anulimin e kamatëvonesave dhe sigurimin e padisë”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2014.

Dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari në datën 31.7.2014, pas 38 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri ka zgjatur gjithsej 4 muaj e 12 ditë, në intervalin kohor 11.2.2014 - 23.6.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

35.2 Dosja 2 – çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 20.2.2015, që i përket paditësit I. B., kundër të paditurit DRSSH Tiranë, me objekt “njohjen e pavërtetësisë në regjistrin themeltar nr.\*\*\*, f. \*\*\* të ish-kooperativës bujqësore Përrenjas sa i përket emrit .... Njohjen e vjetërsisë në punë në ish-kooperativën bujqësore Përrenjas për periudhën .....””, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2015.

Dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja Manjola Bejleri në kryesekretari në datën 18.6.2015, pas 21 ditëve nga shpallja, jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 5 ditë, në intervalin kohor 23.2.2015 - 28.5.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

35.3 Dosja 3 – çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 26.11.2015, që i përket paditësit Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, kundër të paditurit M. Ç., me objekt “detyrimin për kthimin e shumës 34,956 lekë, të përfituara padrejtësisht nga marrëdhëniet e punës”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.2.2016.



Dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari në datën 24.3.2016, pas 30 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 20 ditë, në intervalin kohor 2.12.2015 - 22.2.2016. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

35.4 Dosja 4 – çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 21.10.2013, që i përket paditëses L. M., me të paditur D. B., me objekt “zgjidhje e martesës, lënie e fëmijës për rritje dhe edukim dhe detyrim ushqimor për fëmijën”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.4.2014.

Dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari në datën 8.5.2014, pas 15 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 1 ditë, në intervalin kohor 22.10.2013 - 23.4.2014. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 4-mujor të caktuar nga germa “d”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

35.5 Dosja 5 – çështja administrativo-penale nr. \*\*\* regj., datë 21.11.2014, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësim të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktim të masës së sigurimit “arrest në burg kundër të dyshuarit T. H.”, e përfunduar me vendimin nr. s’ka, datë 22.11.2014.

Dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 22.11.2017, ditën e shpalljes, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri ka zgjatur gjithsej 1 ditë, në intervalin kohor 21.11.2014 - 22.11.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit procedural penal të 48 orëve, të përcaktuar në nenin 258 të Kodit të Procedurës Penale. Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

36. Në vlerësimin e kryer nga KLGJ-ja për tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se, përgjithësisht, gjyqtarja Manjola Bejleri identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri të procedurave të gjykimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

37. Nga pesë dosjet e vëzhguara rezulton se janë ankimuar tri prej tyre. Në një nga rastet, Gjykata e Apelit ka vendosur “mospranim të ankimit”, për shkak se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga ligji (shihni dosjen 1). Në rastin e dytë, Gjykata e Apelit ka vendosur “prishjen e vendimit” dhe kthimin e çështjes për rigjykim (shihni dosjen 2), ndërsa në rastin e tretë Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “lënien në fuqi” të vendimit (shihni dosjen 3). Në 2 rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët (shihni dosjet 4 dhe 5). Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet e përzgjedhura, nuk pasqyrohen të dhëna nëse është ushtruar ose jo ankim nga palët ndërgjyqëse.

38. Përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren Manjola Bejleri rezulton se janë paraqitur 25 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së. 20 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, 10 prej tyre me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura, ndër të cilat 6 prej tyre janë bashkuar me ankesa të tjera, si dhe 2 prej tyre janë arkivuar përveçse si të përsëritura, edhe me arsyetimin se një pjesë e pretendimeve nuk mund të shqyrtohen, pasi procesi është në gjykim

e sipër. 10 ankesat e tjera janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndër të cilat 2 prej tyre janë arkivuar edhe me arsyetimin se nuk mund të shqyrtohen, pasi procesi është në gjykim e sipër si dhe 1 prej tyre mbi pretendimet për korrupsion se ankuesi duhet t'i drejtohet organit të Prokurorisë. 3 prej ankesave të arkivuara me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor janë bashkuar me ankesa të tjera.

39. Pesë ankesa janë verifikuar dhe ka rezultuar se: 3 ankesa janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe në përfundim është vendosur për 2 prej tyre “tërheqje vëmendje me shkrim”, ndërsa ankesa e tretë, me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është “dërguar për kompetencë” këtij institucioni; 2 ankesa janë verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe për një prej tyre është vendosur “evidentim për efekt të vlerësimit etik e profesional” për gjyqtaren Manjola Bejleri dhe është bashkuar me ankesa të tjera të lidhura me të, ndërsa për ankesën tjetër të verifikuar nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtarja dhe ankesa është arkivuar.

40. Në përfundim të hetimit Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegimet e saj lidhur me këto konstatime<sup>25</sup>.

41. Në vijim të prapësimeve, subjekti ka shpjeguar se: *“Për sa i përket afatit të arsyetimit të vendimit, është i vërtetë fakti se për katër prej tyre është realizuar tej afatit ligjor 10-ditor. Sqaroj se dorëzimi me vonesë është bërë për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata më e madhe në vend, ka pasur dhe ka gjithmonë ngarkesën më të lartë të punës. Ndërsa nga studimet e bëra, numri i gjyqtarëve ka qenë gjithmonë më i vogël se duhej në raport me popullsinë e rrethit Tiranë dhe numrit shumë të lartë të çështjeve për shqyrtim që paraqiten në këtë gjykatë, gjithmonë në rritje me disa mijëra në çdo vit. Duke u ndodhur në këto rrethana, me këtë ngarkesë shumë të lartë pune, kam preferuar gjithmonë të ruaj cilësinë e arsyetimit të vendimit, në raport me afatin e dorëzimit.*

*Lidhur me konstatimet e bëra në raportin e vlerësimit profesional të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sqaroj se qëndrimet e mia janë të shprehura me dokumentet shkresore që disponohen nga ju, si edhe me vendimet përkatëse, për çdo çështje të shqyrtuar”.*

42. Trupi gjykues, pasi vlerësoi dhe analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimet e bëra në raportin e vlerësimit profesional nga KLGJ-ja, konstaton se subjekti i rivlerësimit është ndëshkuar në 3 prej rasteve të ankuara me “tërheqje vëmendje me shkrim”, në 2 raste është vendosur “evidentim për efekt të vlerësimit etik dhe profesional” për gjyqtaren dhe në një rast materiali i është dërguar për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi dokumentacionin për këto çështje. Trupi gjykues arrin në përfundimin se znj. Manjola Bejleri nuk i dha vëmendjen e duhur dhe as nuk u përpoq të shpjegonte pozicionin e saj në ato çështje, duke mos u treguar bashkëpunuese me Komisionin.

## **DENONCIMET**

43. Në Komision rezulton se, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Manjola Bejleri janë paraqitur gjithsej 30 denoncime nga publiku së bashku me materialet përkatëse, për të cilat Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime dhe qëndrimin e saj.

44. Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur shpjegimet për secilin nga denoncimet e evidentuara në rezultatet e hetimit.

45. Trupi gjykues, pasi vlerësoi denoncimet e ardhura në Komision, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk i vlerësoi si të tilla që të mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

<sup>25</sup>Për më shumë referojuni raportit të vlerësimit profesional të përgatitur nga KLGJ-ja.

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

46. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

47. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe ndaj saj duhet aplikuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4 dhe në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Manjola Bejlari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 20.10.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese (kundër)**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*

<b>ne detyre 27.09.2000</b>									
<b>Manjola Bejleri</b>									
<b>Gjyqtar- Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane</b>						<b>Rezultati Negativ</b>	<b>-13.037.523</b>		
<b>Monedha Leke</b>									
	<b>2003</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>4.604.114</b>	<b>80.015</b>	<b>344.812</b>	<b>-437.071</b>	<b>139.479</b>	<b>2.841.608</b>	<b>3.749.788</b>	<b>4.781.686</b>	<b>29.035</b>
Trasheguar "Ap.Banimi sip 81.4 m2 ne Fier (5% )									
Trasheguar "Truall me sip. 1114 m2 ne Libohove (12% )									
Trasheguar "Pemetore me sip. 1168 m2 ne Libohove (12% )									
Trasheguar "Toke Djerre me sip. 240m2 ne Libohove (12%)									
Trasheguar"Truall me sip. 432m2 ne Libohove (12%)									
Ap. banimi 99.2m2 (plus truall 57.6m), rr. M.G (25%)		0							
Truall me sip.112m2, rr.M.G (25%)									
Ap.banimi 79.9 m2 ne Rr. M.G (25%)			-						
Automjet tip Volkswagen ( Golf2)	100.000			-100.000					
Ap. banimi 91m2 , rr. H.K (100%)	4.504.114								
Automjet ne perdorim Tip PASSAT, Volkswagen									
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	-	80.015	344.812	-337.071	139.479	2.841.608	3.749.788	4.781.686	29.035
Likuiditete Gjendje	-	80.015	424.827	87.756	227.235	3.052.763	6.802.551	5.374.112	5.403.147
<b>DETYRIME</b>	<b>3.152.008</b>	<b>-189.164</b>	<b>-187.348</b>	<b>-1.895.824</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Kredi Bankare	3.152.008	-189.164	-187.348	-1.895.824					
Huamarrje nga A.B	0								
Huamarrje nga F.B				0	0	0	0		
<b>PASURI NETO = Pasuri - Detyrime</b>	<b>1.452.106</b>	<b>269.178</b>	<b>532.160</b>	<b>1.458.753</b>	<b>139.479</b>	<b>2.841.608</b>	<b>3.749.788</b>	<b>4.781.686</b>	<b>29.035</b>
	<b>2003</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>TE ARDHURA</b>	<b>639.705</b>	<b>809.592</b>	<b>834.260</b>	<b>1.033.358</b>	<b>825.902</b>	<b>3.564.508</b>	<b>1.378.912</b>	<b>1.214.778</b>	<b>1.482.983</b>
Te ardhura nga paga e subjektit si gjyqtare	603.705	773.592	798.260	847.358	789.902	927.848	1.084.707	1.214.778	1.264.890
Fonde dhene ne perdorim nga F.B						1.103.698			
Te ardhura te perfituara nga babai si trashegimi						0			
Te ardhura neto nga interesat						14.962	96.101		
Te ardhura nga shitja e Ap. 79.9m2				0					
Te ardhura te perfituara nga shitja e automjetit Golf2				150.000					
Te ardhura dhurate nga ish b/shorti						1.500.000			
Te ardhura nga ish b/shorti per rritjen e femijes	36.000	36.000	36.000	36.000	36.000	18.000			
Te ardhura/rimbursim nga European Patent Office& INFOCIP							198.104		218.093
<b>SHPENZIME</b>	<b>715.628</b>	<b>746.125</b>	<b>720.885</b>	<b>639.652</b>	<b>2.163.849</b>	<b>849.995</b>	<b>810.655</b>	<b>1.309.013</b>	<b>1.611.925</b>
Shpenzime jetese	187.928	219.114	219.114	273.240	273.240	279.096	282.048	448.552	470.184
Shpenzime me karte						149.723	320.712	295.351	395.581
Shpenzime udhetimesh	-	178.332	160.780	267.973	204.566	386.673	173.392	490.110	671.160
Shpenzime per djaln	78.750	89.100	89.100			34.503	34.503	75.000	75.000
Shpenzime arredimi	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000				
Shpenzim: Kthim shume vellait F.Bejleri									
Shpenzime per Kredine/Interesa	240.321	209.579	201.891	48.439					
Shpenzime Doganimi per automjetin GOLF	158.629								
Shpenzime te ndryshme					1.636.043				
<b>Rezultati= te ardhura - shpenzime - pasuri neto</b>	<b>-1.528.029</b>	<b>-205.711</b>	<b>-418.785</b>	<b>-1.065.047</b>	<b>-1.477.426</b>	<b>-127.095</b>	<b>-3.181.531</b>	<b>-4.875.921</b>	<b>-157.977</b>